

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7656 E mërkurë 19 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga JOSIF PAPAGJONI

Reshat Arbana, 78-vjetori
i gjigantit të skenës



Opinion

Ditës

Nga HARLEY AUSTIN

Natyrë tiranike
e nacionalizmit

Duhet të ndalojmë përhapjen
e propagandës statistikore të
identiteteve kolektive dhe të fillojmë
të jetojmë dhe mendojmë për veten
tonë. Vetëm ...

Vijon në faqen 21

Reshat Arbana mbushi 78 vjeç. E
Rkush nuk e njeh atë?! Artistët
janë kujtesa shëtitëse, ecin udhës së
njëzëvje, të shoqërojnë, të kënaqin,
pikojnë mall ...

Vijon në faqen 20



Reagojnë banorët, shoqërohen 14 veta

Shemben ndërtimet në Jalë, deputeti i PD përplasat me drejtorin e IKMT-së

Basha: Kërcënim nga bashkëpunëtori në vrasjen
e Azemit. Rama do të përgjigjet me kokën e vet

VLORE - Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
ka nisur mëngjesin e djeshëm një aksion për prishjen e 9
objekteve pa leje në Jalë, por ka hasur në kundërshtimin e
banorëve të zonës dhe të pronarëve të bizneseve. Objektet
janë kryesisht hotele një dhe dykatëshe, për të cilat banorët
thanë se kishin ende pushues brenda në momentin ...

Në faqen 8

PRANOHEK DEKRETI I METES/ HAPET GARA PER KOMPANI TE TJERA NDERTIMI

NDRYSHON LIGJI I TEATRIT, DEBATI PS-PD NE KOMISION

Replikat/ Artistët përplasen me deputetët e PD. Plasari: Opozitë e paguar.
Vokshi: Bëmë ç'mundëm. Intelektualët: Gati për burg për të mbrojtur godinën



(Në foto) Komisioni parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Në faqen 2-5

KRIMI NE 2017

Vrasja e të riut
për një karikues,
refuzohet gjykimi i
shkurtuar për autorët

Në faqen 10

DIALOGU ME SERBINE

Hashim Thaçi
paralajmëron:
Do të ndryshojë
Kushtetuta

Në faqen 19

KONCESIONET

Gjilknuri: Shteti
nuk e përballon
dot mirëmbajtjen
e rrugëve

Në faqen 9

RREFIMI I STUDIUESSES

Meri Kumbë: Muzika
rilind me kohën,
ajo do të gjykojë
krijimtarinë

Suplement

REAGON OPOZITA



Zbardhet vendimi
i gjykatës së
Fierit që liron
Ermal Hoxhën

Në faqen 11

EMRAT/ Agjencia e Pronave, formulari TIP për dosjet e viteve 1993-2014

Pronat, si do shpërndahen 267 milionë lekë

Kompensimi, procedura për të përfituar pagesë të përshpejtuar

NGA ORNELA MANJANI

Agjencia e Trajtimit të
Pronave shpërndan 267
milionë lekë për pronarët që
kanë aplikuar për të përfituar
kompensim me pagesë të
përshpejtuar. Ka përfunduar
shqyrtimi administrativ i
25 aplikimeve për kompen-



sim financiar me kërkesë të
veçantë, për të cilat ATP ka
miratuar me vendim pran-
imin e këtyre kërkesave. Fon-
di financiar, i vënë në dispo-
zicion nga Buxheti i Shtetit,
që ATP do të shpërndajë në
total për subjektet përfitues
të këtyre ...

Në faqen 14

TEATRI KOMBËTAR DEBATET

Opozita "thyen" bojkotin, përplasje të forta në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese

Godina e Teatrit Kombëtar, PS pranon dekretin e Metës, por i bën amendime

Sherr Vokshi e Braimllarin me Shalsin: Je ordiner

Deputetët e PS-së në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese pruan dje dekretin e Presidentit Ilir Meta për ndërtimin e godinës së Teatrit Kombëtar, ndërsa propozuan amendamente të reja. Opozita, e cila ishte e pranishme në komision pas disa ditësh bojkoti, akuzoi mazhorancën se "është bandë" bashkë me kryeministrin Rama e kompaninë "Fusha" sh.p.k. Kreu i komisionit, deputeti socialist, Eduard Shalsi tha në mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese se ky nuk është rasti i parë i pranimit të dekretit të presidentit. Deputetët e PD-së dhe LSI-së i mëshuan qëndrimit se pas pranimit të dekretit të presidentit, ligji bëhet nul, ndërsa për ndryshimet e reja që mund të bëhen, procedura duhet që të rifillojë nga e para që të cilësohet ligji i ri, pasi kështu i hiqet mundësia presidentit për veto. "Kemi arritur në konkluzionin e pranimit të dekretit të presidentit. Nuk është rasti i parë që Kuvendi pranon dekretin e presidentit. Kemi rastin kur është kërkuar të rrëzohet dhe kemi rastin kur me argumente është pranuar. Kemi ndërmarrë edhe disa diskutime me individë të ndryshëm apo disa sugjerime që kanë ardhur në vëmendjen e komisionit, psh., afatet për një thirrje të hapur. Në diskutime me grupe të ndryshme kemi arritur sot një draft-propozim që do ta shqyrtojmë në komision në lidhje me ndryshimet në ligj", tha Shalsi. Pas tij e ka marrë fjalën deputetja e PD, Albana Vokshi, e cila përsëriti qëndrimin e opozitës për ligjin për Teatrin dhe deklaroi se nuk mund të bëhet arsimi në ligj, por vetëm të pranohet ose jo dekreti i presidentit. Por Shalsi i ka prerë fjalën pas debateve me Vokshin dhe ka ndërprerë mbledhjen për 10 minuta. Më herët, dekreti i presidentit nuk kaloi në Kuvend, por u shty shqyrtimi dhe vetëm pas deklarates së KE-së për ligjin e posaçëm për Teatrin, mazhoranca ktheu rrugë. Deputetët e opozitës janë rikthyer në sallë, ndërsa kreu i komisionit, Shalsi ka hedhur në votim amendamentet, të cilat janë votuar vetëm nga mazhoranca në sy edhe të deputetëve të opozitës, të cilët kanë kundërshtuar fort këtë veprim. Ligji pritet të kalojë në seancë ditën e enjte.

REAGIMET
Pas mbledhjes së komisionit, deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeja tha: "Kjo është bandë. Po shkallmojnë edhe të vetmin mjet, rregulloren e parlamentit. Sipas rregullore, akti i parë që votohet është pro apo kundër. Në momentin që votohet pro, ligji me të cilin ka thyer presidenti bie, nuk ekziston më, çdo gjë nga procedura parlamentare është nul. Ata pranuan që ligji është një vjedhje e hapur e në vazhdim të këtij plani kërkuan që të fusin pa procedurë pa nënshkrimin e deputetëve ndryshimet. Kjo i mohon presidentit që të ushtrojë veton presidenciale, në një situatë ku nuk ka Gjykatë Kushtetuese. I vetmi mjet për t'i vendosur fre babëzisë është vetja presidenciale. Ata e bëjnë jo se nuk njihin rregullore, është verbimi i hajdutërisë, prova më e gjallë. Deputetët e shumicës janë të lidhur me krimin, janë të blerë nga paratë e pista të "Fushës". Këta pasi rrëzuan sistemin e drejtësisë, rrëzuan edhe presidentin". Por, kryetari i Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Eduard Shalsi shprehet se gjithçka është bërë sipas procedurës parlamentare, pasi për këtë gjë ka precedent parlamentar. Ai shtoi se u reflektua dhe u ndryshua njëra nga pikat që kërkonte presidenti dhe që sugjeroi Brukseli për hapjen e garës. "Kur u pranua dekre-



Deputetët e PS-së në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese

Edmond Panariti: Jemi në kushtet e një shkeljeje flagrante

Deputeti i LSI-së, Edmond Panariti deklaroi dje se nuk mund të amendohet dekreti i presidentit. Pas mbledhjes së Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Panariti tha për gazetaret se, "e vetmja mënyrë që u shkel do të ishte miratimi në tërësi i dekretit. Ky proces nuk mund të amendohet. Mund të paraqitet një nismë e re, që nuk u shpreh. Shkelja ishte flagrante. Jemi në kushtet e një kalimi flagrant të një ligji, unë nuk e konsideroj dekretin të miratuar, por bëhet fjalë për vari-



antim e riformatuar, që i vihet përpara opozitës në momentin e fundit pa u konsultuar". I pyetur se cili do të jetë qëndrimi në Kuvend i opozitës ditën e enjte, Panariti tha se do të konsult-

ohen për të përcaktuar qëndrimin. "Jemi në kushtet e një antikushtetutshmërie. U dhunua e drejta e fjalës së opozitës dhe u kalua me nxitim në mënyrë qesharake ai variant i amenduar në fshehtësi dhe shpejtësi. Presidenti u shpreh qartë dhe ne duhet të shprehim, por u shprehëm pro për variantin aktual, jo të korrigjuara. Shumica mund të merrte një nismë ligjore dhe presidenti ta gjykonte këtë nismë dhe ne jemi në kushtet e një shkeljeje flagrante. Nuk mund të kemi më amendim, jashtë një nisme të re ligjore", tha Panariti.

ti, bëhet nul gjithë ligji? Jo se ka precedent parlamentar për të parë se nuk po bëjmë gjë tjetër, atë që është një praktikë e rëndomtë parlamentare. Shpreh gjithë keqardhjen time, që ato skena të shëmtuara shqiptarët i kanë parë të komisionet që drejtojnë titullarët e opozitës. Jemi përpjekur që ta shmagim nga banalitetet. Do të doja që të njihim shqiptarët me procesin. E kemi thënë se ka dy vizione të ndryshme, ata nuk e dinë se çfarë duan", tha Shalsi. "I kërkuam dhe Konkurrencës që të jepte një mendim për gjithçka. Përgjigja ka

DEBATET NË KOMISIONIN E VEPRIMTARISË PRODHUESE

Vokshi: Jeni shumë në siklet, pse kështu?

Shalsi: Në komisionin që drejton bëj çfarë të duash, këtu dua të respektohen kolegët.

Vokshi: Qenkeni në siklet për etikën, por jo për vjedhjen që po bëhet.

Shalsi: Ndërpritet mbledhja, mblidhem për 10 minuta. Mos dil nga rendi i ditës.

Vokshi: Mos më ndërprit fjalën, se po shkel rregulloren. Jam deputete. Mos më ndërprit. Mos kini frikë. Zoti kryetar, më jep fjalën dhe mos shkel rregulloren. Ju nuk keni shans të mos më jepni më fjalën. Mos u bëni palë me krimin.

Shalsi: Nuk keni shans të bëni këtu siç bëni në komisionet e tjera. Nuk keni shans të bëni edhe këtu ato pislleqet tuaja.

Vokshi: Nuk keni shans të mos më jepni fjalën. Nuk e vazhdojmë mbledhjen po nuk më dhatë fjalën. Është procedurë. Zoti Shalsi, sot po bëheni palë me krimin. Po shkelni rregulloren. Jeni bërë të gjithë hajdutë.

Tabaku: Së pari, të gjithë në këtë mbledhje duhet të kërkojmë ndjesë popullit dhe opozitës se ligji ka kaluar çdo halle të shtetit dhe...

Bardhi: Ore Shalsi, po lërë, mos u trego pa edukatë.

Shalsi: Të paedukatë janë ata që flasin pa leje. Është miratuar dekreti i presidentit. Në praktikën parlamentare të të gjitha qeverive dekretet e presidentit ose rrëzohen, ose miratohen, ose miratohen me dyshime. Dokumentin ia dërguam Autoritetit të Konkurrencës. Kërkojmë mendim nga Autoriteti i Konkurrencës. (Pas debatit me Shalsin, deputetja Vokshi ka dalë në korridor e shoqëruar nga kreu i grupit parlamentar të PD-së, Edmond Spaho).

Vokshi i ka thënë Spahos: Mondi, asnjë s'flet. Vetëm unë do bërtas aty. Unë them të mos marrim pjesë në votim.

Opozita rikthehet në komision

Braimllari: Je gjithë ai burrë aty. Le nam. S'ju vjen zor.

Shalsi: Sa më kokëbosh të jesh, aq më arrogant je.

Braimllari: Je legen, ordiner.

Alibeaj: Votuat pranimin e dekretit të presidentit, që rrëzon ligjin. Ju ka futur Fusha dhe Rama në xhep. Përfitonin se s'ka Gjykatë Kushtetuese. I vutë minat Kushtetueses, tani doni të minoni Teatrin Kombëtar. Po vidhni kompetencën e presidentit.

ardhur. Dekretet e presidentit janë rrëzuar dhe pranuar dhe janë bërë amendamente. Ne kemi një draft që do ia propozojmë seancës dhe pika kryesore ka të bëjë me një garë me një thirrje të hapur për të mundësuar cilindo subjekt që është i interesuar. Kemi një

grup deputetësh që kemi rënë dakord me logjikën e këtyre amendamenteve. Ne po ndjekim një procedurë konform ligjit. Sot kemi një pamje të plotë se çfarë duhej ndryshuar dhe këtë gjë e kemi bërë. Ditën e enjte do të shqyrtojmë amendimet", sqaroi Shalsi.





Darina Tanushi

Deputeti socialist, Ilir Beqaj propozoi dje një projekt me disa ndryshime për ligjin "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: 'Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar'". Pas pranimit të dekretit të Presidentit të Republikës, për godinën e Teatrit Kombëtar, PS propozon disa amendime në ligj. Në këtë variant të ndryshuar hapet gara për çdo kompani, që shpreh interes për ndërtimin e godinës së teatrit të ri dhe hiqet nga projekti i rrëzuar tashmë edhe nga presidenti emri i kompanisë "Fusha" sh.p.k. "Thirrje e hapur" është ftesa e hartuar nga komisioni i negociimit për palët private që janë të interesuar për të paraqitur një propozim për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj. Kjo përcaktohet në nenin 3 të ligjit të amenduar. Po kështu, në nenet e reja shtohet fjala "vlerësim" që në titullin e projektligjit, ndërkohë që në ligjin e vjetër ishte vetëm fjala "negocim" me kompaninë konkrete. "Komisioni i vlerësimit dhe negociimit krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Bashkia Tiranë dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve, si më poshtë vijon: a) Ministria e Drejtësisë, b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë; c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, d) Ministria e Kulturës, e) Avokatura e Shtetit dh) Trupa teatrore".

PETRIT VASILI

"Amendimin e ligjit e ndalon Kushtetuta. Rilindja me votimin idiot për amendimin e ligjit në Komisionin e Vepërimitarive Prodhuese thjesht nxori veten jashtë ligjit. Rilindja pra doli jashtë ligjit se shkeli Kushtetutën. Çdo qëndrim, aksion dhe reagim ndaj rilindjes si është legjitim si ndaj çdo partie që ka dalë jashtë nga babëzia e saj për vjedhjen e pronës publike", tha dje Vasili.



TAULANT BALLA

"Mirë që në Kuvend vijnë me hope dhe kur iu teket, por të paktën të mos marrin përsipër të flasin për shkelje të procedurave parlamentare, ata që nuk kanë lexuar kurrë rregulloren. Apo që s'kanë haber nga praktika parlamentare, në rastet kur dekreti i presidentit pranohet", tha dje kreu i grupit të PS-së, për opozitën.



Socialistët ngarkojnë kryebashkiakun e Tiranës të negociojë me çdo privat

"Teatri", ndryshimet e PS: Të hapet gara për kompani të tjera

Në komisionin e vlerësimit bëhet pjesë trupa aktoriale

Metës sot, Komisioni i Vepërimitarive Prodhuese do të marrë në shqyrtim dhe diskutim draftin e ri që ka përgatitur shumica me relator Ilir Beqjen dhe pas miratimit do i dorëzohet projektligji i ri Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Kujtojmë që ligji i miratuar në fund të korrikut nga shumica u kthye nga presidenti, ndërsa Brukseli rekomandoi hapjen e garës për ndërtimin e Teatrit Kombëtar, duke rinisur edhe njëherë procedurën.



Faksimile e amendamenteve të PS-së dhe të kërkesës dërguar Autoritetit të Konkurrencës

NDRYSHIMET QË JANË BËRË NË LIGJIN E RI

PROJEKTILIGJI Nr. /2018 PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR VLERËSIMIN, NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS ME OBJEKT "PROJEKTIMI DHE REALIZIMI I PROJEKTI URBAN DHE GODINËS SË RE TË TEATRIT KOMBËTAR"

Janë shtuar në nenin 3
4. "Pala private" është çdo subjekt privat që paraqet një propozim për zhvillimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar.
5. "Partneri privat i përgjegjshur" është pala private, propozimi i të cilit ka rezultuar në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe më favorshmi në raport të interesit publik dhe është klasifikuar i pari nga komisioni.
10. "Thirrje e hapur" është ftesa e hartuar nga komisioni i negociimit për palët private që janë të interesuara për të paraqitur një propozim për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

ENI 5 Shtohet si palë Trupa teatrore Përbërje e Komisionit

- 1. Komisioni i vlerësimit dhe negociimit krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, kryesohet nga përfaqësuesi i caktuar nga Bashkia Tiranë dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve, si më poshtë vijon:
a) Ministria e Drejtësisë
b) Ministria e Financave dhe Ekonomisë
c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
d) Ministria e Kulturës
e) Avokatura e Shtetit
dh) Trupa teatrore

ENI 6 Kompetencat e Komisionit të Vlerësimit dhe Negocimit:

- 1. Komisioni shqyrtim propozimet e paraqitura nga çdo palë të interesuar për realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Sipas nenit 4, të këtij ligji, institucionet përkatëse duhet të vendosin menjëherë në dispozicion të Komisionit të negociimit vlerësimin financiar të pasurive shtetërore, për të cilat ai do të negociojë me palën private, në lidhje me përfitimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar. Anëtarët e Komisionit i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas fushës së përgjegjësisë të institucioneve që përfaqësojnë.
3. Me marrjen e propozimeve, komisioni verifikon paraprakisht statusin e të gjitha pronave, mbi të cilat do të zhvillohet projekti, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 3 të këtij ligji. Komisioni verifikon dhe marrëveshjet e arritura dhe të nënshkruara me pronarët privatë që posedojnë pasuritë në zonën e zhvillimit të projektit.
4. Komisioni vlerëson me palët private, propozimet e paraqitura prej tyre dhe harton relacionin përmbyllës të negociatave, duke paraqitur çdo ofertë të paraqitur nga palët private dhe arsyetimin e përgjegjshëm së partnerit privat me propozimin më të mirë.
5. Komisioni studion dhe vlerëson propozimin për zhvillimin e projektit, i cili duhet të përmbajë minimalisht dokumentacionin, si më poshtë vijon:
a) Analizën teknike, e cila duhet të përmbajë sfondin e projektit; konceptin e projektit, vendndodhjen, sipërfaqen e përgjithshme publike e private të zbatimit të projektit, studimet topografike dhe gjeologjike, përshkrimin konstruktiv, funksional e teknik të projektit; standardet teknike, periudhën e vlerësuar të ndërtimit të teatrit.
b) Analizën ekonomike dhe financiare, e cila duhet të përmbajë kostot e projektit.

- c) Çdo dokumentacion tjetër, që do t'i shërbejë për kryerjen e negociatave.
d) Sigurimin e ofertës me 2% të vlerës së projektit të propozuar.
6. Bashkia e Tiranës është përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e të gjitha procesverbalet dhe dokumenteve të procedurës së ligjit dhe të dokumentit tjetër, që lidhet me procedurën e përcaktimit e të negociimit të kushteve të kontratës, përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti.
7. Komisioni i negociimit të kontratës autorizohet dhe gëzon të gjitha të drejtat për vlerësimin dhe propozimin lidhur me jetësimin e pronave në pronësi të pushtetit qendror apo të vetëqeverisjes vendore për realizimin e këtij projekti, bazuar në legjislacionin në fuqi.

ENI 7 Procedura e vlerësimit, negociimit dhe lidhjes së kontratës

- 1. Procedura e vlerësimit, negociimit dhe lidhjes së kontratës do të kryhet nga komisioni, i përcaktuar dhe i ngritur sipas këtij ligji.
2. Pas ngritjes së komisionit, çdo palë private e interesuar mund të propozojë një projekt për zhvillimin e zonës së Teatrit. Afati për dërgimin e propozimeve është 30 ditë nga dita e botimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e komisionit sipas përcaktimit të këtij ligji.
3. Datën e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Komisionit, Bashkia e Tiranës publikon në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen e saj zyrtare njoftimin për depozitim nga çdo palë e interesuar të propozimeve për zhvillimin e zonës urbane të Teatrit. Dokumentacioni depozitohet pranë Bashkisë Tiranë.
4. Pas përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, Komisioni brenda 20 ditëve duhet të shpallë klasifikimin e propozimeve të paraqitura. Në rast se asnjë nga propozimet e paraqitura nga palët private nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 5 të nenit 6 të këtij ligji, komisioni vendos përfundimin e këtij procesi, si një procedurë e pasuksesshme.
5. Pas shpalljes së klasifikimit të propozimeve të paraqitura, çdo subjekt i cili nuk është klasifikuar i pari, ka të drejtë të paraqesë ankim, brenda 5 ditëve tek kryetari i Bashkisë Tiranë. Pas marrjes së ankimit, kryetari i bashkisë, brenda 5 ditëve duhet t'i kërkojë komisionit, rivlerësimin e propozimit ose konfirmim klasifikimin e komisionit.
6. Në rastin e kthimit për rivlerësim, komisioni duhet të kryejë rivlerësimin e propozimit brenda 10 ditëve, dhe e përcjell klasifikimin e kryer të kryetari i bashkisë. Nëse kryetari i bashkisë, pas vlerësimit të dytë nuk është dakord me vlerësimin e komisionit, procedura anulohet si një procedurë e pasuksesshme.
7. Në rastin e konfirmimit të klasifikimit të kryer nga komisioni, atëherë ky i fundit vazhdon negociatat me partnerin privat të përgjegjshur deri në dërgimin e projektkontratës dhe relacionin përmbyllës të negociatave të kryetari i bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.
8. Afati për negociimin dhe hartimin e projektkontratës finale me partnerin privat të përgjegjshur nuk duhet të jetë më shumë se 15 ditë nga data e konfirmimit nga kryetari i bashkisë të klasifikimit të palëve private nga komisioni.
9. Kur partneri privat i përgjegjshur nuk vazhdon negociatat me komisionin brenda një afati prej 5 ditësh, atëherë komisioni fiton për të negociatat me palën private të klasifikuar i dyti.
10. Komisioni i negociimit të kontratës mund të asistohet për marrjen e ekspertizave të specializuara nga një konsulent, i përgjegjshur sipas një procedure të veçantë, të përpëqitur, nga ana e Bashkisë së Tiranës, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Kulturës, në vendim të ngritjes së komisionit të negociimit, sipas pikës 1, të nenit 5, të këtij ligji.

ENI 8 Kontrata dhe përmbajtja e saj

- 1. Kontrata ndërmjet pronarit-shtet dhe partnerit privat të përgjegjshur duhet të përmbajë propozimin e paraqitur nga ky i fundit, sipas këtij ligji, i cili është vlerësuar nga komisioni i negociimit dhe do të jetë pjesë e pandashme e kontratës.

TEATRI KOMBETAR DEBATI

Tupja: Të tentojmë të pamundurën. Lubonja: Duhet sakrificat jonë

Intelektualët: Gati për burg e përplasje fizike për Teatrin

Budina: Të okupojmë godinën

Fatmira Nikolli

Salla "Gëte" e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" që mbushur plot dje me intelektualë të mbledhur për të marrë një vendim për të ardhmen e dy teatrove kombëtarë. Ndërsa ligji që i shemb, miratuar më 5 korrik e i kthyer nga presidenti do të amendohet, pyetja që shtrihet nga Aleanca për Mbrojtjen është: Po tani, si do veprojmë? Restaurimi është opsioni i tyre i kahershëm, por në një kohë që qeveria do të hapë konkurs për një projekt që shemb dy teatro për të ndërtuar një të ri PPP shumëçka mbetet e paqartë. Si fillim, mënyra se si. Dje prej orës 12:00 deri në orën 15:00 arkitektët, shkrimtarë, shoqëri civile e përfaqësues të së djathtës deri deputetë kanë shqyrtuar hapat që mund të ndërmerren.

Maks Velo, Jorida Tabaku, Aurel Plasari, Edmond Tupja, Fatos Lubonja, Artan Raça, Neritan Sejmani, Mirela Karabina, Kastriot Çipi, Alert Çeloalija, Robert e Edmond Budina e dhjetëra të tjerë diskutuan për tri orë. Më poshtë propozimet e tyre, që nga përplasja fizike e burgu, arrinë deri tek okupimi i Teatrit.

FATOS LUBONJA

Kam bërë një shkrim ku i referohem kësaj që po ndodh si ndërkombëtarokratë. Ajo që kam vëmë në dukje unë është një fakt i thjeshtë, që u komentua pak në mediat tona. Lidhur me projektin e Teatrit reagan aktorë, intelektualë, shoqëria civile, opozita, presidenti. Me arrivencë u shpërfillën gjithë këta. Ndërkohë që ky ligj ishte një vjedhje e hapur, nuk reagoi as prokuroria që duhet të reagojë. Pra, në mes të gjithë këtij reagimi, një letër që erdhi nga Brukseli e anuloi. Çfarë ndodhi? Kjo tregon se çfarë sistemi kemi ngritur ne. Është fshirë çdo gjë këtu. Këtu na vjen një letër nga Brukseli dhe këtë ndërkombëtarokrati. Nëse do të zgjidhesh një problem nuk paske forca dhe duhet të ankohesh tek ai më i madhi që ai të kthejë çfarë vendos më i madhi ymë. Një shqëri me një kulturë vertikale sadomazokiste që na fshin në të tërë këtu. Çfarë duhet të bëjmë kur ke vetëm një mundësi për t'i ndryshuar gjërat dhe qahesh e ankohesh te ndërkombëtarët.

Kur nuk funksionon e gjithë struktura, nuk funksionon; duhet mbase t'ua japim pushtetin të huajve se ne nuk bëhemi dot garant i ligjit. Kjo është pjesa pesimiste. Duhet që kushdo nga



ne të ndikojë te ndërkombëtarët.

Është pesimiste, jemi të pafuqishëm. Ne duhet të bëjmë Kukësin. Po ne s'kemi takat, se unë me Maksin e kemi bërë një herë burgun. Mbese këta të rinjtë duhet ta bëjnë, se s'kanë gjë për të humbur. Duhet ta bëjnë që të ndërgjegjësojnë se kështu fitohen gjërat, me forcë me kurajë. Gratë angleze për të fituar të drejtën e votës bënë protestë. U burgosën 1000 veta. Njëra prej tyre i doli para kalit të mbretit, e mori kali e ajo vdiq dhe doli më pas populli i Londrës. Duhet të përpiqemi me ndërkombëtarët për këtë çështje dhe duhet ndjenja e sakrificës. Këto janë dy mënyrat.

BUDINA

Para se të shkojmë te ruspat, ne duhet të okupojmë Teatrin. Duhet të bojkotohet aktiviteti të "Turbina" dhe të bojkotohet ai festival.

EDMOND TUPJA

Për kushte objektive e subjektive i jam bashkuar me vonesë kauzës. Ndjesë! Jam dakord me propozimin e Lubonjës që duhet tentuar e pamundura. E pamundura për mua është sakrificimi i vetvetes. Unë imagjinoj skenarë ekstremë. Po erdhën fadomat, ne do të rrimë atje. Ato mund të vijnë në menatë, por nuk shoh zgjidhje tjetër. As ndërkombëtarëve

nuk u kam besim. Reagojnë me vonesë dhe ata janë njerëz, janë të ndjeshëm ndaj magjisë që u bëhet ose durratave. Duhet të bëjmë diçka me të rinjtë e kolegët tanë në sistemin arsimor. Po kanë frikë se i heqin nga puna. Qëndresa me praninë fizike është një nga mënyrat që na ka mbetur. Ka dëshpërim në fjalën time. Ka dëshpërim se është dhunë, që do pësojmë për vlerat morale e për ideale.

NERITAN SEJMANI

Përforcoj atë që tha Fatosi. Edi Rama me një biznesmen me 4 klasë shkollë ka vendosur të ndërtojë këtu. Plani ka qenë më i madh, ka përfshirë edhe godinën e PD-së dhe 'Sarajet'. Nuk ia doli

LUBONJA

Është pesimiste, jemi të pafuqishëm. Ne duhet të bëjmë Kukësin. Po ne s'kemi takat, se unë me Maksin e kemi bërë një herë burgun. Mbese këta të rinjtë duhet ta bëjnë, se s'kanë gjë për të humbur. Duhet ta bëjnë që të ndërgjegjësojnë se kështu fitohen gjërat, me forcë me kurajë.

të nonsens. Në momentin që vendos autokrati dhe vullneti i tij bëhet ligj, ka marrë fund çdo gjë, çdo lloj koncepti i demokracisë dhe i shtetit. Qëndresa e çdo gjë tjetër ka pasur rezultat, por kjo narativë ka marrë mund. Ia dhanë pa konkurs "Pushës", tani do ia japin me konkurs. E qartë është në këtë histori se ka dy vullnet: është vullneti i Ramës dhe i juaji. Në fund rezultati do të varet nga përplasja e dy vullneteve. Në kuptimin konkret, kjo do zgjidhet vetëm me përplasje fizike. Ai do vendosë që do ta shembë dhe në fund do varet nga qytetarët. Lajmi i mirë është se mjafton 100 veta të arrestohen aty dhe mbyllet, sepse në këta 100 veta do jenë këta emra që janë këtu. Nuk ka një polic e një shofer fadome që do t'i shtyjë me dhunë. Ne u japim pushtet ndërkombëtarëve. Lu-së i lëpohen të gjithë. Ndërkombëtarët duhet të vijnë para hipokrizisë. Ata flasin për reformën në drejtësi, ne do u themi që na e tregoj te Teatrit, ai flet për veting e ne i themi na e tregoj te Teatrit. Çështja e Teatrit duhet të kthehet në gur prove.

MAKS VELO

Kam theksuar se fajin e kemi vetë. Janë prerë koka me gjojinë derisa u bë ajo Francë. Ata thonë se duhet të priti edhe ju koka që të bëhet Teatrit. Se ne e presim çdo gjë nga ndërkombëtarët. Këtë katastrofë e kemi bërë vetë, se ne nuk jemi më të mirë. As këta nuk janë (i drejtohet Albana Vokshit) se këta po të ishin, do e kishin bërë Teatrit e nuk na kishin lënë në këtë dërxeh. Se këta i ngritën kullat e para te bulevardit. Njësoj janë, të gjithë për të vjedhur. Kjo është e keqja, nuk e kapërcëjmë dot vjedhjen. Kjo është aferë vjedhjeje e jo aferë teatri,

ndaj është shumë e vështirë se janë të tërë hajdutë. Rama ka bërë shumë gjëra të mira, nga ligji i duhanit, e pagesën e dritave. Punët policore i bëri perfekt, por punët e vështira nuk i bën dot. Ekonominë nuk e ngrejë dot, s'e bëjnë. Është e vështirë se këtu kanë tradhtuar aktorët. Ka tradhtuar drej-

ÇPI

Meqë qeveria po e braktis ndërtuesin, të kërkojë grupimi ta marrë në dorë, duke marrë përsipër që ta rikonstrukttojë. Duam të marrim në administrim Teatrin, që qeveria nuk e do.

tori i Teatrit, është tradhtari numër një. E ne tani të bëjmë rolin e drejtorit? Nuk e di si do të kalohet ky ngërc. Arkitekti i projektit të ri është një merkato arkitekt-stogastonomike. Ai nuk ka guxim të shkruajë mbi godinën në projekt emrin Teatrit Kombëtar. Ai nuk e ka shkruar. Është projekt i dobët. Rama ka dështuar, ai i jep vendimet vetë edhe kur kemi qenë në komisione. Stadiumi është një katastrofë.

Do kontrollosh tërë hotelin, çdo vrimë të hotellit, tërë kamerierët sa herë të bëhet ndeshje. Ç'marrëzi kemi bërë! Pse është kjo situatë? Arkitektët e kanë dorëzuar licencën, sepse u duhet të marrin leje në bashki për çdo gjë. Në këtë gjendje jemi katandisur të gjithë, nuk hapim dot më gojë. Specialistët tek ne nuk funksionojnë. Se është vetëm kjo Vokshi që vjen e është stresuar për këtë punë, ata të PD e kanë marrë si lojë politike. Duan të rrezojnë Ramën që të vijë vetë. Pse duan këta? Se duan të vijnë këta e të vjedhin vetë.



Takimi i djeshëm i intelektualëve

Çfarë të bëjnë ndërkombëtarët e shkretë? Kë të rregullojnë më parë? Teatrit ishte i vetmi vend që na mbante larg komunizmit. E kemi fajin vetë, se ne i kemi lejuar, se ne duam vetë të blihem. E ndjek me bindje këtë çështje se Teatrit e kam ndjekur vazhdimisht, se Teatrit ishte i vet-

mi që na mban larg komunizmit. Një bizhu ka qenë kinema "17 Nëntori", por edhe atë nuk e kemi. Ke parë t'i presidentët francezë të merren detaje? Presidenti thotë duhet një bibliotekë, por nuk zgjedh projektin.

EDMOND BUDINA

Do thosha vetëm dy fjalë, jam dakord me sa u tha, por duhet të diskutojmë se çfarë do të bëjmë, cilët janë hapat që ne do të marrim konkretisht? Qeveria mashtron? Është e vërtetë. Opozita ka fajin e saj? Është e vërtetë. Edhe unë jam plotësisht kundër të gjitha këtyre. Problemi është cilat janë hapat që do të ndërmerren. E para, të bëjmë çfarë tha Aureli, t'i kthehet përgjigje Komisionit Europian. Duhet që opozita të bëjë debatin e vet në parlament derisa të rrezohe çështja e Teatrit. Teatrit nuk duhet të bjerë, nëse bie Teatrit, ne jemi të marrë fund që të gjithë si shoqëri. Para se të shkojmë të ruspat, ne duhet të okupojmë Teatrin. Përvojat janë. Në teatrit 'Vare' ku unë kam interpretuar, shteti donte që ta shembte, e okupuan artistët dhe



Fatmira Nikolli

Mes diskutimeve për të ardhmen, pati edhe përplasje. Një pjesë e të pranishmëve shohin fajtores për situatën sa qeverinë edhe opozitën. Aurel Plasari, ish-drejtor i Bibliotekës Kombëtare, studiues e përkthyes dhe një ndër zërat më të qartë e me të formuar në mbrojtjen e Teatrit, renditi disa prej problematikave të shfaqura, duke dhënë edhe një farë rrugzgjidhjeje. Por tekta pa gabime edhe te PD, nuk munguan replikat mes tij dhe deputetes Albana Vokshi, njëherësh kryetare e Komisionit të Medias.

AUREL PLASARI

Me zotin Velo do bëjmë dy shkrime të përkundërta. Unë nuk jam dakord me Maksin për projektin e ri. Unë do të shkruaj që ai është një bizhu, është bizhu europiane, botërore, planetare. Rama thotë se ai arkitekti është ndër më të mëdhenjtë e botës, unë do them që ai është më i madhi, po kjo s'ka asnjë lidhje me prishjen e kompleksit të këtuashëm. Ky është kurthi ku të fut Rama me të tijtë, me skilet e tij. Nuk di ndonjë shoqatë e organizatë që të thotë nuk duam teatër. Unë madje dua 10. Devijimi i kauzës që të merremi me bën a s'bën ai projekt na lë në baltë kauzën kryesore. Të vendosë ta bëjë kur të ketë para, të gjejë vendin, se ata e kanë marrë përsipër. Kauza këtu është të mos prishet kjo ndërtesë historike, që mban kujtesën e shtetit shqiptar. Nuk ka shteti shqiptar në Tiranë, ndërtesë më të vjetër në të gjitha ndërtesat historike. Kjo është oruelliane që po bëhet me Teatrin. Mua më kujtohet nga Oruell një skenë shumë tronditëse. Një personazh, është i vetmi që përpigjet të rezistojë nga pastrimi i kujtesës, sepe kanë ngritur një ministri që pastron kujtesën. Ai përpigjet të rezistojë dhe takon një të moshuar, ulet në tryezë dhe e pyet, si ka qenë përpara partisë? Këtë kanë karakteristikë regjimet e tilla, që të mos mbahet mend si ka qenë në regjime të tilla, vetëm nga partia e këtij. Ai thotë nuk mban mend.

Dua të them se ka ca gjëra që nuk duhen ngatërruar në këtë moment kur duhet shpëtuar kompleksin historik. Sigurisht, kjo është betejë politike që përpigjet ta heqë mendjen tek arkitekti, jo është i madh, jo nuk është i madh. Nuk kanë protestuar për këtë çështje njerëzit, që është ajo jo i bukur. Është protestuar për tjetër gjë. Ia kuptoj këtë hile, se është betejë politike. Në luftërat politike ka disa teknika. Midis të mbrapshtit dhe të drejtit, ç'a përdori i mbrapshtit? Përdor hile, mashtrim, intriga, përçarjen.

Ç'a teknikash përdor i drejtë? Të përfitojë që t'i kundërvihet çdo teknike të tillë për ta demantuar e çmontuar. Të thotë sa më shumë me të vërteta e t'i përsërisë sa herë që përsëri-

bënë shfaqje atje. Edhe ne duhet të bëjmë këtë. Duhet të bojkotohet aktiviteti të "Turbina" dhe të bojkotohet ai festival. Kjo duhet të jetë një lëvizje qytetare e përgjithshme.

Ky teatër duhet rikonstruktuar me paratë që mund të mbledhë një fondacion. Për këtë duhet të luftojmë deri në fund.

ROBERT BUDINA
"Europa Nostra" do sjellë një komision të vetin për të parë gjendjen e Teatrit Kombëtar.

KASTRIOT ÇIPI

Ky takim ka filluar me një gjë të tmerrshme. Me intelektualë që janë të gatshëm të bëjnë burg, sepe nuk shohin rrugë tjetër. Kjo është e rëndë. Besoj se Teatri nuk shembet, sado arrogant të jetë Rama. Nëse 2a3 deputetë hyjnë në sallë, ai nuk shembet. Pika ku takohemi është fondacioni që bashkon artistë e qytetarë. Në 2002-shin kemi qenë në njëjtin situatë. Teatri nuk mbrohet me vendime qeverie. Me këtë rast edhe thjesht në dorë të artistëve, Teatri nuk mund të jetë. Edhe ata që drejtojnë fondacion mund të tradhetojnë kauzën. Megjë qeveria po e braktis ndërtesën, të kërkojë grupimi ta marrë në dorë, duke marrë përsipër që ta rikonstruktujë. Nëse ndërtohet një shkollë në një fshat, në Skrapar mund të bëhet kjo. Duam të marrim në administrim Teatrin, që qeveria nuk e do.

SOKOL ANGJELI

Është ditë e gëzuar. Është një tunel sakrificë që duhet të kalojmë. Sepse sakrificë duhet të kalojmë. Megjithëse ka aktorë që nuk janë këtu. Me mendje janë në proces reflektimi. Te "Turbina" përplasen tri institucione. Dhe një drejtore shëhë në shaminë në kokë se s'ka ç'bën. Hajt thonë po e lëmë Kiço London të bëjë ca shfaqje këtu.


"Zonja të opozitës së paguar, do hapni debate po të më jepni mend"

Plasari: Fajet e opozitës së paguar, Vokshi: Bëmë ç'mundëm

Përplasje mes studiuesit e deputetes



Aurel Plasari



Albana Vokshi

PERPLASJA PLASARI-VOKSHI

ALBANA VOKSHI

Nuk dua të bëj replikë me Velon, as me Plasarin, por në fakt nuk ndihmon fakti të thuhet që jeni të gjithë njësoj. Barazitizmi, të thuash që jeni të gjithë të ligj nuk ndihmon në asnjë shoqëri, aq më pak në këto momente. Unë si deputete jam këtu sepe nuk mendoj se jam si gjithë pjesa tjetër, nuk jam njësoj. Nuk jam njësoj si ata që duan ta shkatërrojnë Teatrin, nuk jam njësoj si ata që merren me paratë e drogës. Nuk bie dakord absolutisht me atë që tha Plasari, që jam këtu për të mbrojtur vlerat historike e nuk është këtu për të mbrojtur atë që në kemi thënë e denoncuar. Unë mendoj se Teatri është kurthi i Edi Ramës, sepe nuk është çështja e Teatrit e as e një godine historike.

PLASARI
Ajo tokë publike për privatin po prish Teatrin. Edhe nëse toka mbetet publike, kjo ndërtesë nuk duhet prishur.

VOKSHI
Nuk jam për debat. Zoti Plasari...

PLASARI
Ju qenkeni që të prishet pra.

VOKSHI

Më lini të mbaroj.

PLASARI
Çfarë të mbarosh? E the tani.

VOKSHI
Rama na ka futur në kurth, nuk i intereson Teatri, por...

PLASARI
Mua më intereson vetëm Teatri.

VOKSHI
Ne na intereson edhe Teatri, edhe toka publike.

PLASARI
Po ju jeni opozitë e paguar, për këtë paguheni.

VOKSHI
Më vjen keq, nuk ju fyeja e mos më fryni. Jam që ditën e parë si qytetare, jo si pjesë e opozitës së paguar. Kam bërë detyrën time si deputete e si kryetare komisioni.

PLASARI
Në orar të punës je.

VOKSHI
Nuk ka nevojë për ta banalizuar.

PLASARI
Kur më përmende, të paralajmërova që kam të tjera për opozitën.

VOKSHI
Numëroji. I kam dërguar unë letra UNESCO-s.

PLASARI
E kuptova pse nuk ua ka vënë veshin.

VOKSHI
Kam thënë, siç ka thënë edhe PD se, PD nuk diskuton ligji që

shemb Teatrin. Ka qenë e qartë që ditën e parë që PD nuk diskuton një ligj të personalizuar, sepe është antikushitetues. Sepse merr tokë bashkie pa e kaluar në këshill bashkiak. Jemi të qartë: jo shembje Teatri, e jo antikushitetueshmëri dhe antiligjshmëri. Gara për të cilën flet BE-ja nuk ndihmon nëse ligji është antikushitetues dhe nëse merr tokë publike. E kemi përmendur se nuk kemi Gjykatë Kushtetuese e as Gjykatë të Lartë. Cilado të jetë situata, sa do të agravohet, unë do të jem aty me ju, jo si deputete, por si qytetare. Nuk do ta bëj për partinë time, por për fëmijët e mi.

JORIDA TABAKU
Pa dashur ta bëj debat politik, e falënderoj secilin për atë që ka bërë. Fokusi për ne si parlamentarë duhet të jetë denoncimi. Përgjigja që erdhi nga KE nuk i ezaurio shqetësimet tona. Partia ime mund të ketë bërë shumë gabime në të shkuarën, por kurrë nuk do të më vendosë mua në pozitën që ka vënë PS kolegët e pozitës.

halli. Dhe erdhi ajo përgjigje që erdhi. Kush ia futi? Opozita ia futi. Çfarë shqetësimi ka pasur opozita në deklarata? Tipik kapitalist. Ka të drejtën e saj. Prodhimi, fitimi, ndarja e fitimit. Kjo që diskutohet me ligjin është me termat e ekonomisë politike, ndarje fitimi. Unë jam për çështje krejt tjetër; kujtesa historike që është baza e qytetërimit të një kombi. Pa kujtesën historike, nuk pastrohet. Nëse ndërkombehtarët ndikohen mbi këta arrogantë, atëherë duhen përdorur. Kështu thonë parimet e betejës politike, teknikat.

(Ndërhyn Vokshi)

Zonja të opozitës së paguar, do hapni debate shumë të mëdha këtu po të më jepni mend. Po flas për mbrojtjen e një ndërtesë historike. E quaj gjë të mirë, pasi ju jam drejtuar forcave opozitare, të nesërmen kryetari i njërës ka dalë e ka thënë tri herë jemi kundër shembjes së Teatrit. Pra, presioni duhet bërë në të gjitha palët. Edhe mbi ato që kanë interesa kapitaliste. Po të vijë kritikat e Velos, do thosha ku ishin forcat e paguara opozitare kur u hoq nga lista e monumente? Mbasa s'kanë pasur vëmendje dhe dokumentet duhen parë, si është justifikuar heqja? Unë di që një listë monumentesh kulture vjen duke u shtuar në një komb, jo duke u pakësuar. Këtu na dalin lista që higen. Unë nuk kam fuqi, opozita e paguar ka fuqi. Pas heqjes së atyre monumenteve ka një aferë që Velo e quan vjedhje, por ka një dallavere pas monumenteve që higen nga lista. Derisa jemi në situatën që të huajt dëgjojnë, duhet të shkojmë te ata. I duhet rithënë, kur nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Ai që ka fuqi ta marrë atë shkresë e të thotë se ne tekstin tuaj thotë se duhet ta bëjë shteti shqiptar, por shteti shqiptar nuk i ka këto struktura. Më fal, po shkresës i duhet përgjigjur me shkresë. Kështu bëhet beteja. Beteja për mbrojtjen e kompleksit është me të gjitha forcat ndaj të gjitha forcave politike. Pak shoh që forcat e opozitës së paguar ta shohin se cila është çështja. Rruga që propozoj është të shkruajmë e ta themi të vërtetën sa më shpejt dhe t'i përdorim instancat mdërkombëtare. Kapitalizmi ka logjikë tjetër. Si ndahet tenderi nuk është kauzë dhe e kuptojmë se përgjigja e BE është tallje. Kauza jonë nuk është të hapim tenderin. Është për të mbrojtur kujtesën.

ten mashtrimet. Me zotërinë e tij do merrem unë, do bëj një shkrim për arkitektët e oborrit. Sepse, në njohim poetë e shkrimtarë, muzikantë oborri, por ka edhe arkitektë oborri. Si Speer (Albert Speer), një arkitekt ekselent e brilant për çka askush nuk e vë në dyshim. Ai u dënu në Nuremberg, por jo për arkitekturën e tij, por se shërbim pas shërbimi mori detyrën e ministrit të Armatimeve dhe të Prodhimit të municioneve. Shkallët e shërbimeve të çojnë pastaj në sh-

kallë shumë të mëdha. Ai shkroi kujtimet dhe tregoi se si prezantoheshin projektet në sallat e mëdha. U prezantonte vizitorëve Hitleri sikur të ishin të tija. Dhe dikur Speer fton edhe të atin. Dhe i ati në një moment i thotë: "Të gjithë ju jeni çmendur krejt". Kaq mund t'i thoshte ai Rajhut. Dhe kur Speer doli nga burgu, tha që kemi qenë jo vetëm të çmendur, por do të bënim një qytet shumë të mërzitshëm. Kur kam lexuar këtë, më ka ardhur në mendje çfarë po ndodh këtu.

Pra, nuk do të thotë i talentuar edhe i padiskutueshëm. Thotë Fatosi ndërkombëtarokracia. Pse nuk i është shkruar UNESCO-s? Pa rënë në kurthin e opozitës, se ia përmendi Maksin. Flas për opozitën e paguar, se unë e dalloj veten. Opozita e paguar dhe ajo e papaguar, në shumica këtu jemi opozitë e papaguar. Opozita e paguar e futi në këtë kurth që vendimi për t'ia dhënë atij pa konkurs, prish marrëveshjen e Asocimit a nuk prish. Sepse ky ishte

INTEGRIMI NE BE

INTERVISTA

Presidenti tregon mesazhin që ka marrë në Vatikan: T'u japim mundësi të rinjve për të ardhmen

Meta: Shqipëria në BE, projekt që ndihmon edhe Ballkanin

"Shteti do t'i përmbushë më mirë detyrimet e tij"

Presidenti Ilir Meta ka përbindjen se Shqipëria, anëtare e BE është i vetmi projekt që ndihmon jo vetëm vendin tonë, por të gjithë Ballkanin, madje edhe Europën. Kreu i shteti tha se vokacioni i Shqipërisë në Ballkan është vokacioni i paqes dhe i bashkëjetesës. Z.Meta përmes një interviste për "Vatican News", gjatë vizitës në Selinë e Shenjtë foli për pritjen që i bëri Papa Françesku në Vatikan dhe mesazhet që kanë shkëmbyer. "Nga ky takim kthehem me mesazhin e një angazhimi edhe më të madh për paqe, për bashkëpunim, për t'iu dhënë një mundësi më të madhe të rinjve tanë që të shohin të ardhmen e perspektivën në Shqipëri", deklaroi z.Meta.

Z. President Ilir Meta, çfarë mund të na thoni për audiencën që patët me Papa Françeskun në Vatikan?

Një moment historik për mua personalisht dhe një nder i veçantë të vizitoja Selinë e Shenjtë dhe të pritës nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku, pikërisht tani në prag të 4-vjetorit të vizitës së Tij të parë në Europë, ku ai zgjodhi pikërisht vendin tonë, Shqipërinë. Natyrisht më mbeti në kujtesë nga kjo audiencë, pyetja që gazetarët i kishin bërë në avion Papa Françeskut gjatë kthimit nga Shqipëria për në Romë, se përse kishte zgjedhur një vend që nuk ishte anëtar i Bashkimit Europian për të realizuar një vizitë të parë në kontinent dhe përgjigja e Tij ishte: "Pikërisht për të dhënë një sinjal". Vizita ime në Vatikan në këtë vit historik për ne shqiptarët, sic është Viti i Herroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu, pa dyshim që mbart edhe mesazhin e raportit shumë të fortë midis Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë. Por, në mënyrë të veçantë, të vendosmërisë sonë për të forcuar dhe mbrojtur identitetin tonë shqiptar, ashtu sikurse edhe për të hedhur një hap më tej drejt çeljes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian, shpresojmë gjatë vitit të ardhshëm.

Si e shikoni ju kujdesin atëror dhe dashurinë e Papa Françeskut ndaj popullit shqiptar?

Ati i Shenjtë, Papa Françesku ka treguar që në fillimet e para të Tij në këtë detyrë kaq të lartë, një vëmendje të jashtëzakonshme për Shqipërinë dhe për shqiptarët. Jo vetëm me vizitën e Tij historike 4 vite më parë në vendin tonë, por njëkohësisht me Shenjtërimin e Nënë Terezës, me lumturimin e 38 martirëve të Kishës sonë Katolike, me emërimin Kardinal Nderi në Vatikan të At Ernest Simon Troshani dhe me shumë akte të tjera konkrete. Ashtu sikurse dua të theksoj në mënyrë të veçantë se pikërisht në ditën e Shën Nënë Terezës, Ai lartësoi Kishën Katolike të Kosovës duke e shndërruar në Dioqezë. Të



MESAZHI
"Nga ky takim kthehem me mesazhin e një angazhimi edhe më të madh për paqe, për bashkëpunim, për t'iu dhënë një mundësi më të madhe të rinjve tanë që të shohin të ardhmen e perspektivën në Shqipëri", deklaroi z.Meta.

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, gjatë një konference për shtyp



TAKIMI
Presidenti Ilir Meta dhe kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi takuan dje kreun e PDSH të Maqedonisë, z.Menduh Thaçi. Meta u bëri thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të marrin pjesë në referendumin e 30 shtatorit. "Shqiptarët në Maqedoni të votojnë 'pro' të ardhmes së sigurt europiane të vendit", - tha Meta.

Merr detyrën ambasadori i ri i BE në Tiranë

Zëvendësi i Vlahutin: Hapja e negociatave, moment vendimtar për Shqipërinë

Shefi i ri i Delegacionit të BE në Shqipëri, ambasadori Luigi Soreca, i paraqiti letrat e tij kredenciale Presidentit të Republikës, Ilir Meta. Ambasadori Soreca do të përfaqësojë BE-në në Shqipëri dhe do të shërbejë si shef i Delegacionit të BE-së në Tiranë për katër vitet e ardhshme. "Është një nder të përfaqësoj Bashkimin Evropian në një moment vendimtar për Shqipërinë në rrugën e saj drejt pranimit në BE. Këshilli i Bashkimit Evropian ka përcaktuar një rrugë të qartë drejt hapjes së negociatave për anëtarësim në BE-së për të siguruar që reformat e nevojshme jo vetëm të kon-



shqiptare dhe në koordinim me shtetet anëtare të BE-së për të siguruar që reformat e nevojshme jo vetëm të kon-

DEKLARATA
"Këshilli i BE ka përcaktuar një rrugë të qartë drejt hapjes së negociatave për anëtarësim në qershor të vitit 2019. Do të punoj ngushtësisht me autoritetet shqiptare dhe në koordinim me shtetet anëtare të BE-së", - tha z. Soreca.

solidohen, por edhe të thellohen", theksoi shefi i ri i Delegacionit të BE në Shqipëri, Luigi Soreca. Presidenti

varësisht besimeve e përkatësive etnike.

Çfarë mesazhi do çoni në Shqipëri nga audiencia që patët me Papa Françeskun?

Nga ky takim kthehem me mesazhin e një angazhimi edhe më të madh për paqe, për bashkëpunim, për t'iu dhënë një mundësi më të madhe të rinjve tanë që të shohin të ardhmen e perspektivën në Shqipëri, përmes një edukimi më të mirë, një vëmendjeje më të madhe ndaj tyre dhe natyrisht me besimin se falë kësaj mbështetjeje të Selisë së Shenjtë dhe lutjeve të vetë Papa Françeskut, Shqipëria do të vijojë në rrugën e saj të europianizimit, të modernizimit e njëkohësisht edhe të bashkëjetesës, gjithmonë në paqe me të gjithë

rimet, si ndaj Kishës Katolike, ashtu edhe ndaj komuniteteve të tjera fetare, në drejtim të rikthimit të pronave dhe në drejtim të krijimit të lehtësirave të duhura për aktivitetin e tyre, në dobi të rimëkëmbjes shpirtërore të popullit tonë. Po kështu kam shprehur në mënyrë të veçantë vlerësimet më të mira për angazhimet sociale të Kishës Katolike në Shqipëri, për shumë vepra që janë bërë në dobi të komuniteteve, për përpjekjet e vazhdueshme për të dhënë mesazhet e forcimit të familjes, për të edukuar të rinjtë me vlerat më të mira shoqërore e njerëzore, për t'i mbajtur ata larg fenomeneve si droga, alkooli, që ua humbin qëllimet e mira në jetë dhe frymëzimet për t'iu përkushtuar realizimit të tyre.

Lidhur me bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe bashkësisë katolike në Shqipërisë, çfarë mund të thuhet?

Besoj se do të mund të kemi një bashkëpunim edhe më të dobishëm. Padyshim që bashkëpunimi deri më tani ka qenë i shkëlqyer, por ka ende mjaft mundësi për ta bërë më efikas dhe për të lehtësuar më tej aktivitetin e Kishës Katolike, por edhe të besimeve të tjera në Shqipëri. Shteti do t'i përmbushë më mirë besoj detyrimet e tij.

Shqipëria dhe Bashkimi Europian?

Shqipëria, anëtare e Bashkimit Europian. Ky është i vetmi projekt që nuk ndihmon vetëm Shqipërinë, por edhe Ballkanin, madje edhe vetë Europën.

Cili është vokacioni i Shqipërisë në Ballkan?

Patjetër është vokacioni i paqes dhe i bashkëjetesës. Është vokacion tërësisht europian.



KLOTILDA FERHATI

"Ne jemi të parët që kemi pranuar nevojën për të shtrirë pastrimin që po bëhet në pallatin e drejtësisë edhe në politikën shqiptare. Për këtë arsye, PS mbështet çdo nismë që ndihmon avancimin sa më të shpejtë të këtij procesi vendimtar për të ardhmen europiane të vendit tonë", - thekson deputetja e PS-së, Klotilda Ferhati.

Kreu i PD zbardh pikat e projektit, ku dallon vetingu i politikanëve nga SPAK dhe BKH

Vetingu, Basha-Ramës: Dërgimi në "Venecia", i panevojshëm

"S'do lejojmë daljen e 'peshqve të mëdhenj' nga rrjeta"

Valentina Madani

Demokratët kërkojnë nisjen e procedurave parlamentare për miratimin e vetingut në politikë. Kryetari i PD-së Lulzim Basha gjatë një bashkëbisedimi dje me gazetarët njoftoi se PD i ka dërguar shkresën Kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi për të mblodhur të premtën Këshillin e Legjislacionit për të nisur shqyrtimin e amendimeve kushtetuese për vetingun e politikanëve. "Modeli është i ngjashëm me ligjin e dekriminalizimit. Modeli është i qartë. Detyra i ngarkohet disa institucioneve. Do jetë proces i pavarur dhe nuk ka lidhje me reformën në drejtësi dhe as vetingun në drejtësi", deklaroi z.Basha. Sipas tij e premtja do të jetë edhe dita që starton vetingu i politikanëve. Si provë të vullnetit të mazhorancës, Lulzim Basha bëri një paralajmërim për kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi, të cilit më herët opozita i ishte drejtuar me një shkresë ku i kërkon nisjen e procedurave për shqyrtimin e nismës së saj kushtetuese, ndonëse kryeministri Rama më herët është shprehur se do t'i drejtohet për mendim Komisionit të Venecias. "Shqiptarët nuk kanë kohë të presin. Komisioni i Venecias është shprehur në ligjin për gjyqtarët. Të premtën të mblidhet seanca e Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve. Ruçi duhet të mblodhë Këshillin e Rregullores për të nisur pa vonesë procedurën për shqyrtimin e amendamenteve për vetingun e politikanëve. Më pas propozimi të jetë në sallën e Kuvendit. Është emergjencë të nisë menjëherë procedura", deklaroi z.Basha. Një tjetër mesazh adresoi për kundërshtarin e tij politik të cilin e paralajmëroi se vota pro e mazhorancës do të përcaktojë sjelljen institucionale dhe politike të opozitës, duke lënë të hapur çdo skenar, nga bojkoti i Kuvendit deri te mos hyrja në zgjedhje. "Nëse s'e voton vetingun në politikë, le ta dinë të gjithë shqiptarët që s'ka më asnjë rekurs institucional dhe asnjë mënyrë tjetër për t'u përballur me krimin në mënyrë politike dhe institucionale dhe pasojat do t'i diskutojmë bashkë me shqiptarët për t'i dhënë përgjigjen përfundimtare", u



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

'VENECIA'
Lulzim Basha iu përgjigj edhe deklarates së kryeministrit Edi Rama, i cili u shpreh i gatshëm për ta dërguar projektligjin në Komisionin e Venecias për mendim. Sipas Bashës, një lëvizje e tillë është e panevojshme, sepse sipas tij "Venecia" është shprehur njëherë për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

AKUZA

"Sot në Kuvend kemi përfaqësues direkt të bandave, si Çyrbja dhe politikanë karriere të PS që janë vënë direkt në shërbim të bandave, si Tahiri, Balla, Xhafaj dhe vetë Rama, kryepengu i fabrikës së kokainës së Xibrakës. Ligji për vetingun e politikanëve bazohet në të njëjtin instrument si vetingu, por ndryshe nga ai që u kalua pa votat e opozitës, që çoi në kapjen e komisionerëve. Ligji për vetingun e politikanëve nuk do të lejojë daljen e 'peshqve të mëdhenj' nga rrjeta", - tha z.Basha.

Vetingu, PD letër Ruçit: Mblidh Këshillin e Legjislacionit

Partia Demokratike i dërgoi dje një letër zyrtare Kryetarit të Kuvendit Gramoz Ruçi, ku i kërkojnë mblidhjen e Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve, ditën e premtë. Letra në fjalë është dërguar në emër të PD nga kryetari i Grupit, Edmond Spaho, ku kërkohej që mblidhja të mbahet për vetingun e politikanëve. Kjo e fundit është një nismë e PD, ku kërkohej që të gjithë politikanë, zyrtarë duke përfshirë edhe kryeministrin, t'i nënshtrohen sitës së vetingut. Në letër në fjalë thuhet se është e nevojshme mblidhja e Këshillit pasi nevojitet shkëputja e qeverisë nga krimi.



"Shans për të marrë zgjedhjet"

Rama bën ironi me Bashën: Do veting se s'vjen dot në pushtet

Kryeministri Edi Rama reagon me nota ironie pas deklaruarave të kryeopozitarit Basha, nga selia e Partisë Demokratike. "Ai kriminel është shoku i burrit të motrës së kundërshtarit tim. Mamaja e tij ka lidhje me tre komshinj kriminelë. Krushku i njërit është trafikant që del i lidhur me kundërshtarin tim. Shans për të marrë pushtet me zgjedhje unë s'kam. Prandaj dua veting për lidhjet e tij me krimin", shkruan Rama në një postim në Twitter. Më herët, Basha akuzoi dje kreun e qeverisë, por edhe deputetë e ministra për lidhje me krimin, ndërsa kërkoi që të procesohet sa më shpejt me vetingun në politikë. "Dje, (pardje) nxori Ermal Hoxhën nga burgu, Saimir Tahirit, që u vërtetua me jaht personal që lëvizte nga Mali i Zi, i jep mbrojtje politike, Xhafaj po kështu. Xhafaj dhe Tahiri kanë provat e përfshirjes së Olsi Ramës në Xibrakë, kjo është dosja me të cilën mbahet peng Edi Rama. E mbajnë peng bandat që bëjnë ligjin nga Shkodra në Vlorë", -ishin disa nga akuzat që lëshoi Basha.



sqaronte ndryshimin e vetëm të propozimit të tyre me rolin e BKH dhe SPAK. "Janë dy gjera të ndryshme, SPAK dhe BKH i çojnë në burg. Nëse nuk e votojnë vetingun politik, atëherë ta dinë të gjithë shqiptarët se nuk ka më asnjë mënyrë për t'u përballur me krimin në mënyrë institucionale", -u shpreh Basha. Lideri i opozitës refuzoi propozimin e Edi Ramës për dërgimin e amendamentit kushtetues në Venecia. Sipas Bashës, një lëvizje e tillë është e panevojshme, sepse sipas tij Venecia është shprehur njëherë, për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. "Shqiptarët nuk kanë kohë të presin. Komisioni i Venecias është shprehur në ligjin për gjyqtarët. Të premtën të mblidhet seanca e Këshillit të legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve. Ruçi duhet të mblodhë Këshillin e Rregullores për të nisur pa vonesë procedurën për shqyrtimin e amendamenteve për vetingun e politikanëve. Më pas propozimi të jetë në sallën e Kuvendit", -u shpreh kreun i PD-së. Pa komentuar nuk la edhe arsyen e lirimt nga burgu të Ermal Hoxhës, i arrestuar në operacionin e policisë në laboratorin e drogës në Xibrakë. "U lirua Ermal Hoxha për sjellje të mirë, se nuk nxori emrin e Olsit të Ramës, që është garantuesi i fabrikës së kokainës. Xhafaj dhe Tahiri kanë prova të përfshirjes së Olsi Ramës në laboratorin e drogës së Xibrakës", deklaroi z.Basha.

Opozita mblidhet të enjten në Vlorë, në tryezë edhe Idrizi e Duka

Partia Demokratike nuk do të jetë e pranishme në seancën plenare të së enjtes në Kuvend. Këtë të enjte opozita do të mblidhet në Vlorë, nga ku do të vijojë me fakte denoncimin e bashkëqeverisjes me krimin. Pjesë e këtij takimi do të jetë edhe PAA e Agron Dukës si dhe kreu i PDIU-së, Shpëtim Idrizi, i cili vetëm pak ditë më parë zyrtarizoi paktin me Bashën. Kujtojmë se ky do të jetë takimi i katërt i opozitës në qytetet e vendit. Fillimisht u mblodh në Shkodër, më pas në Elbasan e javën që sapo shkoi në Durrës. Opozita e bashkuar ka bojkotuar seancat plenare të këtij sesioni të ri parlamentar.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA NR. 2/69+2-14, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 8, FAQE 218, SIPERFAQE 85 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ILMI SULA.

ÇMIMI 6.800.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 01.10.2018.

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Përplasja e banorëve me policinë gjatë aksionit të IKMT-së në Jalë

Konfrontohen deputeti i PD-së, Shehaj me kreun e IKMT. Shoqërohen 7 persona, mes tyre edhe një 14-vjeçare

Nis shembja e ndërtimeve në Jalë, banorët përplasen me policinë

"Nuk jemi kriminelë. Pronat i kemi me dokumente, na latë rrugëve"

VLORE

Inspektori Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ka nisur mëngjesin e djeshëm një aksion për prishjen e 9 objekteve pa leje në Jalë, por kanë hasur në kundërshtimin e banorëve të zonës dhe të pronarëve të bizneseve. Objektet janë kryesisht hotele një dhe dykatëshe, për të cilat banorët thanë se kishin ende pushues brenda në momentin e mbërritjes së mjeteve të rënda për prishjen e tyre. Aksioni i IKMT-së ka irrituar tejet banorët, të cilët janë përplasur me forcat e Policisë së Shtetit. Ata kanë deklaruar se po trajtohen si kriminelë dhe se objektet janë në pronën e tyre me ligjin 7501 dhe jo në tokë shtetërore, siç pretendohet. Banorët u shprehën se janë me dokumente të rregullta dhe se çështjen e kanë apeluar edhe në gjykatë. Gjithashtu, ata thanë se nuk kanë marrë asnjë njoftim zyrtar për aksionin, por janë njoftuar vetëm me gojë. Pas pretendimeve të këtyre të fundit ka reaguar zyrtarisht IKMT. Inspektori s'qaroi se objektet që po shemben në Jalë janë ndërtime pa leje dhe të përjashtuara nga procesi i legalizimit. Po sipas IKMT, pronarët e ndërtimeve pa leje janë njoftuar që prej 15 korrikut për prishjen, ndërsa u është bërë thirrje të largoheshin. Kjo për faktin se objektet në fjalë nuk mund të legalizohen, pasi janë ngritur gjatë operacionit të djeshëm në Jalë pati sherr dhe përplasje deri në konfrontim fizik mes deputetit të PD, Agron Shehaj dhe kreut të IKMT-së në Vlorë, Fatmir Meta. Ata i janë drejtuar vazhdimisht njëri-tjetrit me fjalët "hajdut". "U kemi marrë shpirtin njerëzve. E bëni për paratë. Vini si hajdutë këtu. Jeni hajdutë dhe shembni shtëpi", i ka thënë Shehaj inspektorit të IKMT. "Hajdut je ti, hajdut brez pas brezi. Nuk më tregon ti hajdutin. Vini për politikë këtu ju. Politikën bëjeni andej se ju e keni katandisur këtë vend kështu", i është kundërpërgjigjur kryeinspektori Meta deputetit Shehaj. Pavarësisht situatës së tensionuar,



Përplasja mes deputetit të PD-së, Agron Shehaj dhe kreut të IKMT-së Meta



REAGIMI I IKMT-SË

Sipas IMT-së, objektet me sipërfaqe të ndryshme dhe me lartësi një dhe dykatëshe kanë pasur funksione shërbimi, kryesisht në hoteleri. "Aksioni i IKMT ka nisur pasi më parë për këto objekte është bërë procesi i skuadifikimit nga ana e institucionit të ALUZIONI-t, duke u trajtuar si ndërtim i paligjshëm. Pavarësisht kësaj, sërish IKMT-së ka bërë njoftimet sipas ligjit. IKMT ka qenë e mbështetur edhe nga Policia e Shtetit në këtë aksion", - thuhet në njoftim zyrtar të këtij inspektorati.

DEPUTETI SHEHAJ

Pas nisjes së aksionit të IKMT-së, kanë mbërritur në Jalë dy deputetët e PD-së Agron Shehaj dhe Nada Mecorapaj. Ndërkohë, Agron Shehaj deklaroi dje se janë 10 persona të shoqëruar, mes tyre është edhe një e mitur. "Vazhdon terrori i policisë kundër popullit të pambrojtur. Mbi 10 të arrestuar (përfshirë një 14-vjeçare) në Jalë midis qytetarëve që protestojnë kundër prishjes së banesave në mënyrë arbitrare nga qeveria", - ka shkruar deputeti.

"Bashkëpunëtori i vrasjes së Azemit kërcënoi deputetin e PD-së"

"Jala", Basha paralajmëron Ramën: Do përgjigjesh me kokën tënde, po u prek një fije floku e opozitarëve



Tiranë banda që ekzekutoi Azem Hajdarin. Po atë natë banda u kthye në Tropojë, pa u ndaluar nga askush. "Pra, policore në Jalë ka qëllim grabitjen e trojeve. Ndërhurja ka qenë e dhunshme dhe e paligjshme. Toka do i kalojë në pronësi Ministrisë së

Mbrojtjes për t'u shndërruar në pasuri të miqve të Ramës. Është e njëjta skemë si me Teatrin. Ndërkohë që kompleksin e Alban Xhillarit, donatorit të Ramës që ka zaptuar bregdetin e Jalës nuk e preku. Deputetët tanë u nisën menjëherë pasi shpërtheu konflikti dhe dhunimit të banorëve. Policia dhe IKMT janë sjellë si banditë edhe me deputetët e opozitës. Kryeinspektori Fatmir Meta kërcënoi deputetin Shehaj, ndërkohë që ishte në detyrën e tij. Fatmiri i Nasibës është ish-shefi i komisarariatit të Tropojës në periudhën më të errët. Me makinën e tij udhëtoi në Tiranë banda që ekzekutoi Azem Hajdarin. Po atë natë,

banda u kthye në Tropojë pa u ndaluar nga askush. Asokohe së bashku me bandat u vranë 86 qytetarë, njëri prej të cilëve oficeri i policisë. Meta u vendos në krye të komisarariatit si shpërblim me bandën e Zani Çaushtit. Ndërsa tani bashkëpunëtori në vrasjen e Hajdarit i shërbën bandës së Ramës dhe Xhafajt. PD do të deponojë sot (dje) padinë për banditin, rrota e drejtësisë do ta kapë për bishti, ndërsa Ramës po i jap këtë paralajmërim: nëse i preket një fije floku cdo opozitari nga banditi yt, përgjegjësinë do ta mbash ti në kokën tënde", tha Z.Basha.

aksiioni ka vijuar, ndërsa policia ka shoqëruar 7 persona, mes tyre edhe një vajzë 14 vjeçe.

PËRPLASJA NË JALË

Banorët e Jalës kanë kundërshtuar ashpër aksionin e IKMT-së, duke u shprehur se kanë 30 vite në këtë tokë. Sipas tyre, pavarësisht vendimit të ALUZIONI-t, ven-

dimi për prishjen e objekteve nuk duhet të ishte dhënë. "Kam dokumentet e pronës, të cilën e kemi me ligjin 7501. Ne jemi në pronën tonë dhe nuk jemi futur absolutisht asnjë metër brenda kufirit. E vetmja arsye që po na i prishin ndërtimet është se ata pretendojnë se ne jemi futur brenda territorit të

SHPU në Jalë, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve. Ne e vërtetojmë që nuk është kështu me dokumente. Për këtë kemi bërë edhe ankimim në Gjykatën e Vlorës. Ne jemi në proces gjyqësor dhe e kemi ankimuar brenda afateve kohore. Sot (dje) kanë ardhur pa njoftim paraprak dhe pa

një vendim", tha një prej pronarëve të ndërtimeve që janë parashikuar të prishen në Jalë. Mes tensionit dhe dhimbjes që ndërtesat, të cilat i kanë ndërtuar me mund po u shemben, një prej banorëve nuk kurseu dhe ironinë. "Bravo shteti shqiptar që po kapni kriminelët. U lumtë, a keni gjak, a keni

cipë? S'jemi kriminelë, i kemi bërë me djersët e ballit. Sa bukur o komandant". Ndërsa një vajzë ka shpërthyer me të qara dhe ulërima. "Dua të iki të shtëpia ime. Më lini! Kush je ti që më jep urdhër?". Ndërsa, një tjetër banor u shpreh: "Këtu është korrupsion i madh, duan rëren, duan edhe malin. Duan të na heqin objektet që kemi 30 vite si familje. Duan të na asgjësojnë krejtësisht. Sot jemi midis rrugëve. Në orën 07:30 kanë sjellë tërë këto forca sigurie, kam bërë një gabim në jetën time: I dhashë 300 vota Edi Ramës që më ka mashtruar".

Miratohet huaja 16 milionë dollarë për Tiranë-Elbasan, ministri: Mund të tarifohet

Ornela Manjani

Gjikhuri: Shtetit nuk përballon koston e mirëmbajtjes së rrugëve

Paralajmërohen rrugë të tjera me pagesë

Buxheti i shtetit nuk përballon koston për mirëmbajtjen e rrugëve. Për të mbuluar gropën që krijohet në buxhet paralajmërohet vendosja e tarifave në disa aksë, përfshirë Tiranë-Elbasan, qytetarët të paguajnë tarifë. Paralajmërimin e ka dhënë dje në Komisionin e Ekonomisë ministri i Infrastrukturasë Damian Gjikhuri, i cili deklaroi se Buxheti i Shtetit e ka të pamundur të mbulojë koston e mirëmbajtjes, gjë që e bën të domosdoshme tarifimin e disa segmenteve në vend. Mirëmbajtja e rrugëve në Shqipëri kap një kosto prej 50 mln eurosh, ndërsa mundësitë e buxhetit janë vetëm për 30 mln. Ndërkohë që kreu i Komisionit të Ekonomisë, i kërkon prokurorisë që të hetojë me seriozitet abuzimet me Tiranë-Elbasan. Për përfundimin e rrugës Tiranë-Elbasan, Komisioni i Ekonomisë miratoi marrëveshjen për marrjen e 16 mln dollarëve nga OPEC, një kredi me terma të buta për përfundimin e segmentit të mbetur në Tiranë-Elbasan.



Ministri i Infrastrukturasë, Damian Gjikhuri

KOMISIONI

Komisioni Parlamentar i Ekonomisë ka miratuar projektligjin që i ndez dritën jeshile marrjes së një huaje të re prej 16 milionë dollarësh për përfundimin e Rrugës Tiranë-Elbasan. I pranishëm në komision, ministri i Infrastrukturasë dhe Energjisë Damian Gjikhuri shpjegoi se huaja e më-

parshme prej 35 milionë eurosh ishte e pamjaftueshme për të përfunduar punimet. Në këtë mënyrë, kostoja e rrugës Tiranë-Elbasan rritet me 44%, duke shkuar nga 312 milionë dollarë në projektin fillestar, në 450 milionë dollarë. Koston jashtëzakonisht të fryra për këtë rrugë u vunë në shënjestër të kritikave nga deputetët e komisionit.

Kreu i komisionit Erion Braçe kërkoi përshejtimin e hetimeve nga prokuroria për të zbardhur shkaktarët e këtyre kostove, ndërkohë që ratorjia e draftit Evis Kushi kërkoi informacion mbi afatet e përfundimit të rrugës, garanci nëse kjo do ishte huaja e fundit për këtë rrugë, si dhe nëse do mirëmbahet nga buxheti apo do jepej me koncesion. Gjikhuri shpjegoi se rruga do të përfundojë brenda këtij viti, për këtë kërkoi proceduar të përshejtuar miratimi, duke anashkaluar afatin dy javor nga publikimi në Fletoren Zyrtare. Kreu i Komisionit Erjon Braçe tha se Kuvendi do komunikojë me presidentin, në mënyrë që kredia të lëvrohet në kohë rekord dhe punimet të nisën përpara stinës së shirave.

DEBATI

DAMIAN GJIKHURI: Sot që flasim kërkohet minimalisht 50 milionë euro për mirëmbajtjen normale për sistemin tonë rrugor. Aktualisht financojmë pak më pak se 30. Qeveritë e mëparshme nuk kanë financuar më shumë se 2 miliardë lekë. Ka ardhur momenti që përdoruesit e rrugës të kontribuojnë për mirëmbajtjen e rrugës. Parimi, sipas të cilit, ai që përdor rrugën, e konsumon më shumë është e vetmja zgjidhje që kanë gjetur të gjithë vendet e botës, aq më tepër vendet me buxhet të varfër si Shqipëria. Ka marrë më shumë kohë dhe më shumë para nga buxheti i shtetit seç ka qenë i menduar më parë. Kjo vepër ka qenë planifikuar të mbarojë për 312 milionë dollarë, kjo rrugë prej 27 km dhe sot që flasim do të shkojë 450 milionë dollarë.

ERJON BRAÇE: Dua t'i bëj një apel Prokurorisë së Republikës, administrata e ka bërë detyrën e saj me hetimin e gjithë kësaj historie, tani duhet që prokuroria të përshejtojë hetimin për gjithçka që ka ndodhur në këtë rrugë.

Guvernatori lajmëron ndryshimin

Sejko: Rritja po zhvendoset drejt industrisë dhe eksporteve

Ekonomia shqiptare ka filluar të zhvendoset nga tregu dhe ndërtimi tek industria, turizmi dhe shërbimet e lidhura me eksportet. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, tha të martën se ka sinjale të një modeli të ndryshëm të rritjes ekonomike, por koha dhe zhvendosja e burimeve që kërkon ky proces do të shoqërohet me një ngadalësim të përkohshëm të produktivitetit. Sipas Guvernatorit, maturimi i këtij procesi dhe rritja e produktivitetit do të kërkojë përmirësimin e aftësive menaxheriale të biznesit.



Drejtori ekzekutiv i Bankës Botërore, Patrizio Pagano, tha gjatë një prezantimi të mbajtur në Bankën e Shqipërisë, se pesimizmi për një stanjacion të rritjes në ekonomitë e zhvilluara me shumë gjasa, është i gabuar. Sipas tij, studimet ekonomike nuk duhet të nënvlerësojnë potencialet e teknologjive ekzistuese si burime të rritjes së ardhshme ekonomike. Pas recesioneve, studimet ekonomike përgjithësisht karakterizohen nga parashikime të zymta. Por, përvoja ka treguar se këto parashikime zakonisht kanë rezultuar të gabuara, sepse ato kanë nënvlerësuar potencialet e teknologjive ekzistuese. Pas depresionit të madh, studimet e ishin pesimiste rreth rritjes së ekonomisë dhe e cilësimit në atë si të varur nga konsumi, ndërsa investimet ishin të pamjaftueshme për një rritje afatgjatë. Por, ato studime nënvlerësuan ndikimin që do të kishte në ekonomi energjia elektrike dhe gjithë shpikjet dhe shërbimet e lidhura me të. Në mënyrë të ngjashme sot po nënvlerësohen potencialet që ka teknologjia e informacionit dhe komunikimit, për të prodhuar shërbime të reja që do të mbështesin rritjen ekonomike.

Ndryshon ligji për tatimin mbi të ardhurat

Shitblerja e tokave, 15 për qind tatim, dhurimi përjashtohet



SHKALLA E TATIMIT MBI FITIMIN ËSHTË:

5 % për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
15 % për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.
Për personat juridikë, të cilët zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas ligjit nr. 38/2012, "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor", shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %.

bujqësore, tatohet me normën 15 për qind, ndërsa shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme. Për sub-

jektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfi-

tojnë statusin "subjekt i certifikuar agroturizmi", deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfundimit të statusit "subjekt i certifikuar agroturizmi." Në ligj është parashikuar edhe ndryshimi në skemën e tatimit për lojërat e fatit. "Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji," thuhet në ligjin e botuar në Fletoren Zyrtare.

Përplasja me armë në Tiranë, arrestohet pronari i lokalit

Pas ngjarjes së ndodhur mbrëmjen e së hënës në rrugën "Shefqet Musaraj", ku pas një shërri të çastit pati të shtëna me armë, të tjera detaje dalin në dritë. Burime zyrtare nga policia pohuan se në pranga ra shtetasi Laert Hita, pronari i lokalit, i cili akuzohet për veprat penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak" dhe "Kanosje". Gjithashtu, u identifikua shtetasi tjetër i përfshirë në konflikt. Bëhet fjalë për 50-vjeçarin Ardjan Pashaj, i cili u shpall në

KONFLIKTI

Laert Hita dhe Ardjan Pashaj mbrëmjen e së hënës në rrugën "Shefqet Musaraj", në lokalin në pronësi të Laert Hites janë zënë verbalisht për motive banale dhe me pas janë konfliktuar me grushte. Fill pas këtij episodi, Pashaj ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar me tytë në ballë Hitajn.

kërkim për veprat penale "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë" dhe "Prodhimi dhe

mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak". Këta shtetas mbrëmjen e së



hënës në rrugën "Shefqet Musaraj", në lokal në pronësi të Laert Hita, për motive të

dobëta janë zënë verbalisht për motive banale dhe me pas janë konfliktuar me grushte.

Fill pas këtij episodi, Pashaj ka nxjerrë pistoletën dhe e ka qëlluar me tytë në ballë Hitajn. Më pas ky i fundit është kundërpërgjigjur duke e qëlluar me pistoletë, por plumbi nuk e kapi, ndërsa Pashaj i është përgjigjur me zjarr dhe më pas është larguar nga lokali. Hita nuk ka pasur plagë të shkaktuara nga arma e zjarrit, por burimet thonë se është përpjekur të fshehtë ngjarjen. Vetëm kur është përballur me kamerat e sigurisë që tregonin momen-

tin e konfliktit mes tyre ai ka pranuar sherrin fizik që çoi më pas në përdorimin e armëve. Kujtojmë se kanë qytetarët ata që kanë sinjalizuar policinë për të shtënat me armë zjarri dhe një person të plagosur, por në momentin që kanë mbërritur blutë e kryeqytetit nuk kanë gjetur asnjë person, pasi 35-vjeçari fillimisht është larguar nga vendi i ngjarjes. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur.

Gjykata nuk pranon kërkesën për veçim të çështjes për vëllezërit Kridens dhe Marsel Alla

Vrasja e Marvi Mihalit, refuzohet kërkesa e Dejvi dhe Eugen Bitrajt për gjykimin e shkurtuar

Hetimet zbulojnë pjesëmarrjen e një tjetër personi në krim

Gjykata e Krimeve të Rënda rrëzoi ditën e djeshme kërkesën për gjykim të shkurtuar ndaj dy kushërinjve Dejvi dhe Eugen Bitraj, të akuzuar për vrasjen e Marvi Mihalit në vitin 2017. Sipas gjykatës gjykimin e shkurtuar nuk do sqaronte rrethanat dhe do e dëmtonte më shumë çështjen. Po ashtu gjykata ka rrëzuar kërkesën për veçim të çështjes për vëllezërit Kridens dhe Marsel Allës. Në gjykatë janë pyetur edhe prindërit e Marvi Mihalit, të cilët janë shprehur se nuk janë dakord me gjykimin e shkurtuar. Ndërkohë një vit pas vrasjes së të riut Marvi Mihalit, prokuroria ka dyshime të forta se në krim nuk morën pjesë vetëm të pandehurit Dejvi Bitraj, Eugen Bitraj, Marsel e Kridens Alla, por edhe një person i pestë ende i paidentifikuar. Gjatë seancës prokurori Gjergji Tako lexoi kërkesën për gjykim për të pandehurit, ndaj të cilëve rëndon akuzat e vrasjes me paramendim në bashkëpunim në dëm të studentit 22-vjeçar. Prokuroria tha se ka dyshime se një person i pestë ka bashkëpunuar me të pandehurit në krim, pasi dëshmitari okular, ka shpjeguar se natën e ngjarjes ka parë një person tjetër që nuk ishte Dejvi Bitraj, i cili mbante në duar një thikë. Pavarësisht kësaj dëshmie, mbetet mister personi i pestë. Procesi rifillon me akuzën e vrasjes së kryer me paramendim. Për këtë ngjarje fillimisht u ngrit akuzat e vrasjes vetëm për njërin prej të pandehurve, ndërsa për tre të tjerët, atë të moskallëzimit të kriminit. Vetëm pas reagimit të prindërve të viktimës, të cilët këmbëngulin për drejtësi, prokuroria kërkoi në seancë paraprake ashpërsimin e akuzës, e cila u miratua nga gjykata, por pavarësisht kësaj dy vëllezërit Alla ia dolën të aratiseshin. Fakti që vrasja e të riut, vijon të jetë e mbuluar nga misteri dhe janë të paqarta shumë rrethana, e



Marvi Mihalit

GJYKIMI I SHKURTUAR

Fakti që vrasja e të riut vijon të jetë e mbuluar nga misteri dhe janë të paqarta shumë rrethana, e detyroi gjykatën të refuzonte kërkesën e kushërinjve Bitraj për gjykim të shkurtuar dhe të vëllezërve Alla për veçim të çështjes.

detyroi gjykatën të refuzonte kërkesën e kushërinjve Bitraj për gjykim të shkurtuar dhe të vëllezërve Alla për veçim të çështjes.


HETIMI

Pas vrasjes së Marvi Mihalit, ranë në pranga 4 të rinj. Konkretisht Eugen Bitraj, Kridens Alla dhe Marsel Alla u akuzuan për moskallëzim krimi, ndërsa Devi Bitraj akuzohet për vrasje me paramendim. Më datë 11 maj gjykatësit Sokol Pasho dhe Bedri Qorri i liruan tre të rinjtë e akuzuar për moskallëzim krimi për shkak se kishin mbaruar afatet e paraburgim-

it. Kjo gjë ka sjellë irritimin e prindërve të viktimës, të cilët kanë kallëzuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, prokurorin Artan Lulaj, dhe dy gjykatësit Sokol Pasho e Bedri Qorri. Pas reagimit të prindërve u ndryshua prokurori i çështjes dhe dosjen e mori në dorë Gjergji Tako, i cili kërkoi ndryshimin e masës së sigurisë për 3 të rinjtë e liruar. Ai kërkoi rikthimin e të rinjve në qeli dhe po ashtu ndryshimin e akuzës nga "moskallëzim krimi" në "bashkëpunëtor në vrasje" së bashku me Devi Bitrajn.

DËSHMITARI

Ndërkohë një vit pas vrasjes së të riut Marvi Mihalit, prokuroria ka dyshime të forta se në krim nuk morën pjesë vetëm të pandehurit Dejvi Bitraj, Eugen Bitraj, Marsel e Kridens Alla, por edhe një person i pestë ende i paidentifikuar. Kjo pasi dëshmitari okular, ka shpjeguar se natën e ngjarjes ka parë një person tjetër që nuk ishte Dejvi Bitraj, i cili mbante në duar një thikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPLLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese (KPA), bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin ligjtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organe dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit":

I - Shpall vendin vakant për pozicionin "Specialist Sekretarie Gjyqësore"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për tu pajisur me Çertifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator në një nga format e dhëna më poshtë:

- Parashkrimi së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 20 Shtator 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Shtator deri më 20 Shtator 2018 në adresën: info@kpa.al. KPA konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 (një) kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notuarizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetimi nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

Ish-i përndjekuri protestë për pronën, lidh veten me zinxhirë



Një ish-i burgosur politik protestoi për orë të tëra ditën e djeshme i lidhur me zinxhirë para agjencisë së trajtimit të pronës në Tiranë, për të shprehur indignatën për vlerësimin e ulët që shteti i ka bërë pronës së tij në Lezhë. Ku për 52 dym tokë është dëmshpërblye me 25 milionë lekë të vjetra. Vetë institucioni përgjegjës, Agjencia e Trajtit të Pronës nuk e mohon pretendimin e qytetarit porse mbrohet me argumentin se vlerësimi i

pronës është bërë në bazë të ligjeve në fuqi dhe se drejtësinë në tilla raste e vendos gjykata administrative. Përfaqësuesit e ATP-së pranuan shifrën e vlerësimit të pronës që bazohet në ligjet në fuqi duke argumentuar se në tilla raste çështjen duhet ta zgjidhë gjykata administrative. Kujtojmë se Dush Martini është një personazh i njohur i përfshirë në protestat e ish-të përndjekurve. Më herët ai ka treguar kalvarin e vuajtjeve, që nga vjedhja e pronës e deri në vitet e tij në burg. Po ashtu

ai është një nga pjesëmarrësit në revoltën e Qafë-Barit. Ai ka bërë 11 vite burg politik për tentativë arratisje dhe prishje të pronës socialiste. Martini ka denoncuar po ashtu se të gjithë njerëz që kanë marrë pjesë në dënimin e tij në atë kohë, deri vonë kanë qenë drejtues në gjykatë.

Strasburgu rrezon pretendimin e Frrokut: Ndalim i paligjshëm



Gjykata e Strasburgut ka rrëzuar pretendimin e ish-deputetit Mark Frroku se ndalimin e tij, është shkelur neni 5 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Vendi i Gjykatës së Strasburgut është bërë publik ditën e djeshme dhe thuhet se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut. "Rasti e ka origjinin në një kërkesë (nr.47403/15) kundër Republikës së Shqipërisë të parqitur në gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") nga një shtetas shqiptar, Mark Frroku ("aplikanti"), më 22 shtator 2015. Aplikanti u përfaqësua nga z. T. Prendi, një avokat që praktikon në Tiranë. Qeveria shqiptare u përfaqësua nga agjenti i tyre, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se ndalimi i tij në lidhje me akuzat sipas nenit 257/ a dhe 287 të Kodit Penal ishte i paligjshëm. Më 5 shkurt 2016, anke-

sa në lidhje me paligjshëmërinë e paraburgimit të tij në lidhje me akuzat sipas neneve 257/ a dhe 287 të Kodit Penal u komunikua qeverisë dhe pjesa tjetër e kërkesës u shpall e papranueshme sipas Rregullës 54 § 3, Rregullorja e Gjykatës", thuhet në vendimin e gjykatës.

I akuzuar si pjesë e grupit "Xibraka", Hoxha duhet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës

Lirimi i Ermal Hoxhës, zbardhet vendimi i gjykatës së Fierit

I pezullohet 1 vit e 6 muaj burg dënim i mbetur



VENDIMI

Më datë 13 shtator është firmosur vendimi, i cili mban firmën e gjyqtarit të gjykatës së Fierit, Piro Sota. Sipas vendimit trupi gjykues ka pranuar kërkesën e Ermal Hoxhës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit, me kusht që gjatë një afati prove të barabartë me pjesën e mbetur të dënimit, ai duhet të mbajë kontakte me Zyren Vendore të Shërbimit të Provës dhe mos kryejë asnjë veprë tjetër penal.

pas hetimeve, Ermal Hoxha, ka pasur rolin e financuesit dhe të financierit. Ai ishte personi që mbulonte likuidimin e drogës kur hynte në Shqipëri dhe që merrte paratë nga marrësit kur nxirrnin kokainë jashtë vendit. Nipi i Enver Hoxhës u arres-

tua pasi më parë ishte firmuar nga agjentët e policisë në laboratorin e drogës në Xibrakë të Elbasanit. Ermal Hoxha bashkë me tetë të pandehurit e dosjes, përfshi edhe dy shtetas kolombiane, u deklaruan fajtorë nga Krimet e Rënda dhe u dënu-

"Hoxha ka mbrojtjen e Ramës"

Salianji: Lirimi i Hoxhës, thikë pas shpine për ndërkombëtarët

Përmes deputetit, Ervin Salianji, PD u shpreh se lirimi para kohe i trafikantit të kokainës, Ermal Hoxha, është provë e qartë se vendi kontrollohet nga krimi. "Lirimi nga burgu para kohe i Ermal Hoxhës është provë se si krimi i organizuar kontrollon vendin me ndihmën e Edi Ramës. Shqiptarët duhet ta dinë se trafikanti i kokainës është liruar para kohe nga burgu se ka mbrojtjen direkte të kryeministrit. Rama kështu merr në mbrojtje vëllanë e tij Olsi Rama, që është ndërtues kryesor i laboratorit të drogës së Xibrakës. Ulja drastike e dënimit është thikë pas shpine edhe ndaj ndërkombëtarëve. Opozita kërkon menjëherë vetingun e politikanëve për të shkëputur lidhjet e krimit me politikën", tha Salianji.



an me 105 vjet burg në total. Ndërsa Apeli i Krimeve të Rënda vendosi në nëntor të vitit të shkua dënimin e tyre në total me 63 vjet burg, duke zbritur kështu jo pak, por 38 vjet nga dënimin e mëparshëm. Mes të dënuarve që përfitoi ulje ishte edhe Er-

mal Hoxha, nipi i ish-diktatorit Enver Hoxha. Nga 10 vjet burg që dha shkalla e parë e krimeve, Ermal Hoxha u dënua me 6 vjet e 8 muaj burg, ndërkohë që tashmë i ka mbetur 1 vit e gjysmë burg, kohë të cilën do ta shlyejë me kusht jashtë qelisë.

Gjendet i vdekur çobani,

dyshohet për vetëvrasje TROPOJË - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbremë në një zonë të thellë të Tropojës. Nga të dhënat paraprake dyshohet se ka mbetur i vrarë një bari në rrethana ende të paqarta. Ngjarja mësohet se është raportuar përmes një telefonate në sallën operative. Telefonata e ardhur në sallë ka njoftuar se personi mund të jetë vetëvrasë me armë zjarri në mal, pasi ai ishte me bagëti në zonat e thella të Tropojës. Policia është nisur menjëherë për në vendngjarje nga ku edhe do të saktësojë nëse bëhet fjalë për një vrasje apo vetëvrasje të çobanit.

Digjet një makinë,

pronarja: Më kërcënuan SHKODËR - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm është djegur pjesërisht një makinë në qytetin e Shkodrës. Ngjarja ka ndodhur në lagjen "Vojo Kushi". Mjeti tip "Ford" me targë AA 368 RA ka qenë i parkuar në anë të rrugës "Qemal Draçini" kur persona ende të paidentifikuar e kanë spërkatur me lëndë djegëse dhe më pas i kanë vënë flakën. Sipas bluve, makina është në pronësi të shtetases Arjana Lukaj, banuese në fshatin Stajkë të bashkisë Vau Dejës, ndërsa prej disa kohësh jetonte në një pallat në lagjen "Vojo Kushi", shumë afër vendi ku u dogj makina e saj. Lukaj ka deklaruar se ngjarja është e qëllimshme, një mesazh kërcënues. Kjo ngjarje sipas pronares së makinës mund të ketë lidhje me biznesin ku ajo është e përfshirë, një lokal dhe baste sportive në afërsi të bustit të Prekë Calit në Shkodër. Ndërkaq, blutë po hetojnë për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

SHPALLJE ANKANDI
Date 21.09.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dyle për pasurinë e paluajshme të dorëzanesve Petrit Sami Sina dhe Majlinda Alushi Sina.

"Apartment" me sipërfaqe 54m2, me nr. pasurie 11/26-1-7, zona kadastrale 2932, vol. 14, faqe 26, adresa: Lagja "Gjokë Doc", Peshkopi, Dibër.

Çmimi fillësar i ankandit të dyle është në shumën 1 120 000 (një milion e njëqind e njëzet mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e tote për pasurinë e paluajshme të debitorit Enkolea Shaban Novaku dhe dorëzansit Adriatik Selor Novaku.

"Trulli" me sipërfaqe 100 m2 dhe "Nderetëse" me 3 kate me sipërfaqe 90 m2 secili, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 5551, vol. 13, faqe 49, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec.

Çmimi fillësar i ankandit të tote është në shumën 6 552 000 (gjashtë milionin e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPALLJE ANKANDI
Date 24.09.2018, Ora 16:45

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajshme të dorëzansit Bajfar Alushi Murto.

"Trulli-Nderetëse" me sipërfaqe trulli 300 m2 dhe ndërtesë 81 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me volum nr. 3, faqe 76, zona kadastrale 3316, nr. i pasurisë 987, adresa: Shales, Sarandë.

Çmimi fillësar i ankandit të parë është në shumën 1 440 000 (një milion e katërqind e dyzet mijë) lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



NJOFTIM PUNËSIMI

POZICIONI I PUNËS: DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO

INSTITUTI EUROPIAN PASHKO është një organizatë jofitimprurëse themeluar nga EEI / Iniciativa Europiane për Edukim, si agregim i më shumë se 10 viteve veprimtari në mbështetje të: lirisë ekonomike, inovacionit, lirisë së shtypit, botimeve dhe de batit të ideve, kreativitetit dhe të trashëgimisë kulturore. IEP udhëhiqet nga vlerat e aksionit afirmativ, europianizimit të shoqërisë shqiptare, reformizmit, liberalizimit ekonomik dhe politik, për nder të ideve të profesor Gramoz Pashko, emrin e të cilit mban ky institut, falë dashamirisë së familjes Pashko. / GRAMOZ PASHKO, profesor, ekonomist liberal, figurë sui generis intelektuale, një nga liderët e lëvizjes demokratike të "Dhjetorit 1990" dhe themeluesi i universitetit të parë privat në Shqipëri në vitin 2002. /IEP do të promovojë nëpërmjet gjashtë programeve vlerat e demokracisë liberale, ekonomisë së lirë të tregut dhe europianizimit.

DOKUMENTET E KËRKUARA

CV e hollësishme
Diplomë Master Shkencor / PhD / Certifikata të ndryshme

KRITERET

Të ketë përfunduar studimet në Shkenca Politike/ Juridik / Shkenca komunikimi / Menaxhim / Marketing ose në fusha të përafërta. Të ketë afësi shumë të mira komunikimi dhe strategjike për negociim me të tjerët. Kandidati duhet të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie me palët e interesuara, partnerët e IEP, institucione jo-qeveritare dhe qeveritare, institucionet rregullatore dhe mediat. Gjithashtu duhet të ketë eksperiencë në zhvillimin strategjik dhe zbatimin e modeleve të anëtarësimit dhe kodet e sjelljes, si dhe të ruaj një vlerësim të lartë të rëndësisë së markës dhe objektivave të organizatës që drejton

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës
20 Shtator 2018, ora 15.00, në adresën: kebjana.haka@uet.edu.al



PROGRAMET E INSTITUTIT EUROPIAN PASHKO



DO TË JESH PJESË E STAFIT AKADEMIK TË UET? APLIKO TANI!

I UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS REKRUTON STAF NË FUSHAT:

1. Shkenca Ekonomike
2. Shkenca Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
3. Shkenca Humane, Edukimi dhe Arte Liberale
4. Shkenca të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës
5. Shkenca Mjekësore Teknike

II DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E PEDAGOGUT

1. Mësimdhënie në tre ciklet e studimit BA/MA/DR
2. Këshillim i studentëve
3. Angazhimi në veprimtari kërkimore - shkencore
4. Mbështetje për institucionin

III KRITERET E NJË KANDIDATI TË SUKSESSHËM

1. Preferohet që kandidati të ketë përfunduar të paktën një cikël studimesh (BA/MA/DR) në një universitet anglo-sakson.
2. Të jetë i aftë të garantojë cilësinë, efikasitetin dhe ekselencën e zhvillimit të lëndëve që do të japë dhe t'i përgjigjet me fleksibilitet nevojave të universitetit;
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie në shkollën e lartë dhe në fushën e kërkimit shkencor të mirëfilltë.

DOKUMENTET E KËRKUARA

- #### IV
- CV e hollësishme e kandidatit në gjuhën shqipe.
 - Letër motivimi në të cilën të shpjegohen qartë interesat profesionale, fushat e ekspertizës dhe lëndët e synuara.
 - Kopje të listës së notave, shoqëruar me diplomën përkatëse të ciklit të parë dhe të dytë. (notë mesatare mbi 9-të).
 - Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/ titujve akademikë
 - Për studimet e kryera jashtë Republikës së Shqipërisë, diploma duhet të jetë e njehsuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin.

-Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në: hr@uet.edu.al ose në zyrën e Burimeve Njerëzore deri më 20 Shtator 2018.

-Konkursi zhvillohet në datat 26-27-28 Shtator 2018

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, info@uet.edu.al



FAKULTETI I EKONOMISË
BIZNESIT
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE
JURIDIKE, POLITIKE
DHE MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË
EDUKIMIT DHE
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË
INFORMATIKËS
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCAVE
MJEKËSORE
TEKNIKE



Burime nga Shërbimi i Hematologjisë: Ilaçet janë dhënë, por në sasi më të vogla

Voltiza Duro

Ende vazhdon problemi i mungesës së medikamenteve për pacientët hemofilikë që trajtohen në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Të pyetur nga 'Gazeta Shqiptare' pacientët tregojnë të shqetësuar se farmacia e QSUT nuk ka gjendje të ilaçeve, kështu që nuk i ngelet veçse të presin. "Jemi në pritje dhe shpresojmë që t'i sjellin medikamentet. Pyeta te farmacia në QSUT dhe farmacistja më tha se duhet të përgatitemi pasi pritja e ilaçit do të jetë e gjatë. Unë po trajtohem me faktorin 9, para disa ditësh mora gjysmën e dozës dhe sot (dje) erdha prapë", tregon Fitim Allciu për 'Gazeta Shqiptare'. Ndërkohë, 22 vjeçari Besart Nezaj është një tjetër pacient me hemofilinë në stadin e rëndë. Ditën e djeshme ai i ka nisur një letër Avokatit të Popullit ku kërkon një zgjidhje të situatës. "Përveçse me Hemofilin B, forma e rënde në jam diagnostikuar dhe me prani të Inhibitorëve, me titër të lartë kundër faktorit IX (nëntë). Inhibitori është frenues, i cili pengon/parandalon efektin e faktorit 9-të dhe në të shumtën e rasteve vjen si pasojë e mungesës së profilaksisë për Hemofilinë, në këto kushte Hemorragjia është më e madhe, rrezikohem të

Pacientët me hemofili, në pritje të medikamenteve pranë QSUT-së

"Farmacistja na tha të presim, gjendja po përkeqësohet"



Besart Nezaj, pacient hemofilik



Fitim Allciu, pacient hemofilik

QSUT

Burime nga Shërbimi i Hematologjisë bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se medikamenti është marrë, por në sasi më të vogla. "Nga 3000 unite, kanë marrë 2000 të tilla, por mjaftojnë, sepse medikamenti merret përditë. Ilaçet janë marrë me vonesë, por janë marrë!", - theksojnë burimet nga QSUT për 'GSH'.

kem hemorragji spontane, cerebrale, hematoma në inde, vështirësi të theksuara në lëvizje, pasi kjo substancë (Inhibitori) e parandalon efektin e faktorit 9-të, duke rrezikuar

drejt përdrejt jetën time", - thekson Nezaj. Ky i fundit shton se në Shqipëri Inhibitori nuk Diagnostikohet as Trajtohet sikurse duhet, pasi mungojnë laboratorë të specializuar për diagnostikimin e cilësisë dhe sasisë së Inhibitorit, por dhe ka mungesë së faktorit 7-të. "Unë trajtohem me NovoSeven Faktor 7-të, por ka mungesa pasi është me dona-

cion. Pavarësisht thirrjeve të mia se Inhibitori është i rrezikshëm për jetën time, ka një heshitje nga institucionet e QSUT, MSHMS, por dhe institucioneve të pavarura, të cilat pretendojnë të jenë të tilla. Profilaksia është një nevojë urgjente për Hemofilinë dhe mirëqenien e tyre", shton i riu. Ai thekson se mungesa e medikamenteve dhe pritja në

radhë për orë të tëra përkeqëson gjendjen e tyre shëndetësore dhe iu shkakton edhe më shumë hemorragji. "Drejtorja e QSUT-së jep një sasi të caktuar dhe e ndan në 5 apo 10 pacientë, pra në nuk mjaftojnë me sasinë e duhur, pasi ajo ndahet në sasi të ndryshme, duke mos i dhënë pacientit sasinë e përshkruar në recetë. Farmacistët që na japin faktorin shprehen se nuk ka mjaftueshëm medikament", - thotë Nezaj.

REAGIMI I QSUT

Burime nga Shërbimi i Hematologjisë bëjnë me dije për 'Gazeta Shqiptare' se medikamenti është marrë, por në sasi më të vogla. "Nga 3000 unite, kanë marrë 2000 të tilla, por mjaftojnë, sepse medikamenti merret përditë. Ilaçet janë marrë me vonesë, por janë marrë!", - theksojnë burimet nga QSUT për 'GSH'.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË 15-20 SHTATOR DP/DIPLOMË PROFESIONALE/ 2018-2019

Kontabilitet
Menaxhim
Turizëm

Dizajn i Aplikuar dhe Modë

Aplikime Informatike

Këtë vit akademik hapen për herë të parë në UET Diplomat Profesionale. Zgjidh një universitet të madh për të hyrë në botën e profesioneve

DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI I EKONOMISË BIZNESIT DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE JURIDIKE, POLITIKE DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË EDUKIMIT DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË INFORMATIKËS DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Kompensimi për vitet 1993- 2014, dokumentacioni që vërteton pronësinë e subjektit

ATP shpërndan 267 milionë lekë për pagesat e përsheptuara

Agjencia, 10 dokumentet që i bashkëlidhen formularit

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitit të Pronave shpërndan 267 milionë për pronarët që kanë aplikuar për të përfutur kompensim me pagesë të përsheptuar. Ka përfunduar shqyrtimi administrativ i 25 aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, për të cilat ATP ka miratuar me vendim pranimin e këtyre kërkesave. Fondi financiar, i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që ATP do të shpërndajë në total për subjektet përfutur të këtyre 25 aplikimeve sipas kërkesave të tyre, është në vlerën 267 milionë lekë. Agjencia e Trajtitit të Pronave njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfutur të të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditët në vazhdim.

APLIKIMI

Të gjithë ish-pronarët që kanë aplikuar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të përfutur kthimin ose kompensimin duhet të paraqiten pranë agjencisë për të plotësuar formularët për pagesa të përsheptuara ose për t'u bërë pjesë e ankandeve të kompensimit fizik. Mund të aplikojnë për pagesë të përsheptuar pronarët që kanë aplikuar për kompensim në vitet 1993-2014. Është në dëshirë të pronarit plotësimi i secilit prej formularëve, por është e domosdoshme që pas plotësimit të tij të paraqesin në Agjencinë e Trajtitit të Pronave 10 dokumente.

PAGESAT E PËRSHEPTUARA

Janë vendosur tri afate pagesash të përsheptuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vjetësh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së faturës, për pagesën brenda tre viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere. Të gjithë subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin

Faksimile e formularit TIP me fjalëqori të përdorur në formularin nga qyteti për të plotësuar formularin.

ISH-PRONARËT

Të gjithë ish-pronarët që kanë aplikuar në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të përfutur kthimin ose kompensimin duhet të paraqiten pranë agjencisë për të plotësuar formularët për pagesa të përsheptuara ose për t'u bërë pjesë e ankandeve të kompensimit fizik.

PAGESAT E PËRSHEPTUARA

1. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 1 viti, atëherë ai përfiton 20% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere;
2. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 3 vjetësh, atëherë ai përfiton 30% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere;
3. Kur subjekti kërkon të kompensohet financiarisht brenda 5 vjetësh, atëherë ai përfiton 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlere.
4. Prioritet do të kenë aplikimet që kërkojnë të kompensohen financiarisht brenda 1 viti, nga kërkesat për kompensim brenda 3 apo 5 vjetësh.

LISTA E SUBJEKTEVE QË PËRFUTTOJNË KOMPENSIM FINANCIAR ME KËRKESË TË VEÇANTË												
NR.	VENDIMI I KKKP				QARKU	SUBJEKTI I SHPRONËSUAR		PËRFAQËSUESI ME PROKURË		APLIKIMI NË ATP		KËRKESA E SUBJEKTI
	NR.	DATE	MUAJ	VITI		EMËR	MBIEMËR	EMËR	MBIEMËR	NR.	DT. E APLIKIMIT	
1	41	29	4	1995	Dibër	Abdulla	Xhaka	Xheladin	Xhaka	1247	20.10.2017	20%
2	143	8	6	1995	Tirane	Zija	Rizvanolli	Nusret	Rizvanolli	397	10.05.2017	20%
3	348	24	11	1995	Tirane	Haxhi	Petrela	Violeta	Petrela	1124	20.09.2017	20%
4	124	3	7	2007	Korçë	Mustafa	Hasin	Eqerem	Bajram	378	02.05.2007	20%
5	64	17	3	2008	Vlorë	Sedat	Libohova	Hektor	Canaj	995	01.08.2018	20%
6	118	22	4	1994	Korçë	Sybi	Blaceri	Nexhmi	Blaceri	1181	06.10.2017	30%
7	74	1	3	1994	Korçë	Mihal	Tushi	Liljana	Mato	457	12.10.2016	40%
8	299	27	3	1994	Tirane	Xhavit	Stermasi	Gentian	Nebijaj	295	11.04.2017	40%
9	228/2	18	5	1994	Elbasan	Tasim	Luniku	Firuze	Arap	741	15.12.2016	40%
10	629	15	8	1994	Tirane	Safi	Grebleshi	Bashkim	Grubleshi	1152	29.09.2017	40%
11	1226	25	2	1995	Tirane	Aishe dhe Kume	Karapici	Merita	Karapici	444	15.05.2017	40%
12	87	25	5	1995	Fier	Sulo	Shahu	Fatbardha	Baro	1494	22.12.2017	40%
13	250	1	9	1995	Tirane	Myslym	Karapici	Merita	Karapici	656	07.06.2017	40%
14	139	29	5	2006	Vlorë	Resmi	Osmani	Majlinda	Vreshtazi	278	05.04.2017	40%
15	197	5	10	2007	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1480	18.12.2017	40%
16	198	5	10	2007	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1476	18.12.2017	40%
17	285	9	1	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1477	18.12.2017	40%
18	287	16	1	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1478	18.12.2017	40%
19	30	14	2	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1474	18.12.2007	40%
20	83	15	4	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1475	18.12.2017	40%
21	84	15	4	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1471	18.12.2017	40%
22	105	29	4	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1473	18.12.2017	40%
23	106	29	4	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1470	18.12.2017	40%
24	134	23	5	2008	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1479	18.12.2017	40%
25	96	30	3	2009	Tirane	Njazi	Tirana	Hilda	Basha	1472	18.12.2017	40%

vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedure: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjithë subjektet kërkues, të cilët shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të çeljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar, pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

DOKUMENTET

Për pagesën e përsheptuar paraqitet: Kërkesa për kompensim fizik me pronë shtetërore, vendim përfundimtar të ish-AKKP-së, shoqëruar me planvendosjen e vendimit, vërtetimin nga zyrtarë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për statusin juridik të pronës që kërkohet, shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën regjuese dhe vërtetimin nga bashkia se sipërfaqja e tokës, sipas studimit dhe/ose gjendjes faktike, nuk ka funksion publik.

ELITA RUDI, NJË NUSE TRADICIONALE, BËN GATI PAJËN

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E mërkurë 19 Shtator 2018



“Më pëlqen të jem një Ferrari”, Oriola i çmendti të gjithë me imazhin e fundit



Këngëtarja shqiptare tregon hapur sa e ka “pazarin”

BULEVARDI POLITIK



- Në kulmin e debatit për Teatrin, deputeti shikon video për ‘shtatë palë qeife’...
- Rama fotografohet në avion, shmang çmimet e “kripura”
- Nuk jeni të vetmit! Edhe ministri i Brendshëm i mban lekët te kasa e telefonit
- Erdogani merr dhuratë luksoze 400 mln dollarë, përballet me kritika të mëdha



Rrëfehet studiuesja: Pasioni për punën më rigjeneron shpirtin, ja çastet me djalin

MERI KUMBE:

Muzika rilind në kohë, ajo do gjykojë krijimtarinë

“Ekspozimi i fëmijëve ndaj tingujve është i domosdoshëm”

Rrëfëhet studiuesja: Pasioni për punën më rigjeneron shpirtin, ja çastet me djalin

Meri Kumbe: Muzika rilind në kohë, ajo do gjykojë krijimtarinë

"Ekspozimi i fëmijëve ndaj tingujve është i domosdoshëm"

Egla Xhemali

Të bësh atë që do, t'u japësh frymë dhe gjërave që s'frymojnë, të ndjesh fort si regëtin vala e asaj që i ke dhënë trajtë është një formë e suksesit. Meri Kumbe, pedagogia në Universitetin e Arteve e njëkohësisht studiuese muzike vjen në një rrëfim mjaft të veçantë për "Summer pages" të "Gazeta shqiptare", për të ndarë me ne punën që e bën me pasion, thellimin e studimeve të saj, si dhe kohën që kalon me të birin. Kumbe nëpërmjet rrëfimit jep mesazhin se asgjë nuk është e pamundur, nëse ke dëshirë dhe këmbëngul për t'ia dalë. Studiuesja, e cila u bë mjaft e famshme për punën intensive me kodikët pohan se ishte më e vështirë gjetja e dokumentacionit se sa puna me ta. Meri na tregon për dashurinë e madhe që ka për bibliotekat dhe arkivat dhe se si një pjesë të madhe të ditëve kur ishte në shkollë e kalonte në ambientet e preferuara të saj. Përpos punës, një pjesë të mirë të kohës e ndan me familjen dhe shoqërinë. Pas lodhjes, pedagogia gjen qetësi kur është me të birin. Më tej, Kumbe pohan se dëgjon muzikë të mirë. Ajo thotë gjithashtu se është gjithëpërfshirëse dhe e ekuilibruar dhe se ekspozimi i fëmijëve ndaj muzikës është i domosdoshëm. Sa i përket cilësisë së muzikës, Meri ia lë kohës vlerësimin e krijimtarisë së gjithsecilit.

Si është tradita psaltike në viset shqiptare?
Arti psaltik ka qenë i përhapur thuajse në pjesën më të madhe të hapësirës gjeografike në të cilën ndodhet sot Republika e Shqipërisë. Nga studimet e realizuara, në mes të shekullit të XX, ajo dokumentohet kryesisht në jug, në juglindje, në Shqipërinë e Mesme si edhe në qytetin e Shkodrës dhe disa fshatra përreth tij. Deri në fillim të shek. XX, arti psaltik ishte tërësisht i ndikuar nga Konstantinopojja. Me krijim e shtetit shqiptar nisën



përpjekjet për një kishë "kom-bëtare", krijimi i së cilës pati impakt direkt edhe në muzikën fetare. Përkthimi në gjuhën shqipe u shoqërua me një sërë fenomenesh të reja (për artin psaltik në Shqipëri) si transkriptimi në pentagram dhe harmonizimi i këngëve fetare.

Sa ndikuan marrëdhëniet politike të kohës në historinë e këngës fetare të Kishës Ortodokse?

Për aq sa mund të duket e çuditshme, politikat e kohës patën ndikim direkt edhe në muzikën fetare. Fan Noli dhe vepra muzikore kishtarë e tij, futi për herë të parë në kishën ortodokse muzikën ruse. Traditën e Kievit si edhe kompozime të kompozitorëve në zë si Çajkofski, Korsakov, etj. Shumë interesante janë përplasjet e besimtarëve të publikuara në shtypin e kohës (tek gazeta "Gjergj Kastrioti" e viti 1924), të cilët replikojnë mbi këto risi muzikore. Një grup besimtarësh i konsideron të panevojshme dhe të huaja këto ndërhyrje muzikore, ndërsa një tjetër grup i mbështet si zhvillime moderne të muzikës fetare.

Ju jeni e njohur për punën tuaj mbi kodikët muzikorë. Nëse do të krahasonit, ku qën-

dron vështirësia më e madhe që keni hasur përgjatë punës kërkimore?

Puna kërkimore në vetvete është aq sa e vështirë, edhe e bukur. Kërkon durim, insistim dhe shumë disiplinë. Mund të them që më i vështirë ka qenë kërkimi i dokumentacionit mbi shekullin e XX sesa puna me kodikët. Nga pikëpamja arkivore, kodikët janë të inventarizuar mirë dhe tërësisht të aksesueshëm nga arkivistët. Pra, shërbimi është më konkret dhe më i shpejtë. E kundërta, me dokumentet arkivore, për llojin e tyre kërkohet më shumë kohë. Për më tepër që ishin të shumta rastet kur në një dosje të caktuar gjendeshin partitura muzikore, të cilat kam fatin e madh t'i studioj dhe publikoj për herë të parë.

Çfarë lini pas dorë për t'u marrë gjatë me studime?

(Qesh) Nuk di të them. Mua më pëlqejnë shumë arkivat dhe bibliotekat dhe që në rininë e hershme (vitet e studimit) shpenzoja në to pothuajse të gjitha paratet e mundshme. Sigurisht, një pjesë e kohës që shpenzoja dikur në arkiv, sot e ka zëvendësuar puna. Ndër të tjera jetoj normalisht si të gjithë bashkëmoshatarët e mi dhe kohën e lirë e ndaj midis familjes dhe shoqërisë. Nuk besoj që lë gjë pas dorë. Zgjedh herët në mëngjes, kështu kam kohë për të gjithë aktivitetin e programuar.

Si është momenti i pushimeve pas një pune të thelluar?

Kryesisht në natyrë dhe tanimë kryesisht me djalin tim të vogël, të cilit përpiqem t'i kushtoj kohë sa më cilësore.

Diskutimi më i fundit që keni pasur mes kolegësh?

Diskutimi ka qenë kryesisht i fokusuar në krijimin e mundësive të reja për kërkimin shkencor. Puna në arkiv është e bukur, por ka edhe kosto. Fatqësisht insti-



tucionet e arsimit të lartë në Shqipëri ende nuk janë zhvilluar mjaftueshëm në pikëpamje të përthithjes së fondeve europiane, dedikuar kërkimit shkencor. Kështu që shpesh, diskutimet tona fokusohen në këtë fushë, në mënyrë që të krijohet mundësi financiare për më shumë. Në këtë pikë, krijimi i strukturave teknike manaxhuese (të tipit "found raising") pranë universiteteve do të ishte ideale.

Ku është përqendruar interesi aktual mbi studimet muzikore?

Nënkupton në përgjithësi? Janë të shumtë kolegët që mbulojnë fusha të ndryshme si historia e muzikës shqiptare, etnomuzikologjia apo mbi lloje dhe gjini të caktuara të muzikës. Personalisht nuk e kam vendosur ende ku do të fokusoj studimin e radhës.

Sa përzgjedhëse jeni në muzikë?

Jam shumë përzgjedhëse dhe përpiqem të dëgjoj muzikë të mirë. Kryesisht rock, jazz, blues si edhe këngë të njohura franceze. Ndërkohë, këtë vit jam edhe më e kujdesshme lidhur me muzikën që dëgjoj në shtëpi për shkak të tim birit. Kështu që mundohem të jem gjithëpërfshirëse dhe e ekuili-

bruar. Ekspozimi i fëmijëve ndaj muzikës është i domosdoshëm, jo vetëm nga pikëpamje e zhvillimit sensoro-motorik, por edhe në pikëpamje estetike, të kultivimit të shijes.

Çfarë sugjeroni për një shije ndryshe?

Nuk mund të përzgjedh, pasi më pëlqejnë shumë gjini të ndryshme muzikore. Por, do sugjeroja që njerëzit të mos jenë shumë selektiv, në sensin që të dëgjojnë sa më shumë muzikë të jetë e mundur, pasi zgjeron jo vetëm kulturën muzikore, por edhe na ndihmon që të jem pak më të qetë e të qeshur gjatë ditës.

Sa muzikë cilësore po bëhet sot në Shqipëri?

Kjo është pyetje relativisht e vështirë. Sigurisht, tranzicioni i pas-viteve '90 përfshiu të gjithë shoqërinë, përfshirë edhe krijimtarinë muzikore. Por nuk mund themi që kanë munguar krijimet cilësore. Në fakt, krijimtaria muzikore, sidomos ajo e muzikës serioze, u sprovua me teknika të reja kompozicionale. Ndërsa në rastin e këngës, mendoj që u ndesh me një krizë identiteti. Gjithsesi, koha do të jetë ajo që do e gjykojë krijimtarinë. Muzika rilind në kohë...



"Më pëlqen të jem një Ferrari", Oriola i çmendi të gjithë me imazhin e fundit

Venia në plan të parë e formave trupore dhe fakti që nuk e lënë asnjëherë të qetë, tashmë është bërë shprehje për Oriola Marashin. Modelja arrin të marrë vëmendjen e fansave sa herë që publikon fotografi në rrjetet sociale. Në profilin e saj në "Instagram" ka publikuar disa fotografi me bikini. Një imazh të tillë, modelja e ka postuar së fundmi, ku linjat e saj janë për t'u admiruar. "Më pëlqen të jem një 'Ferrari'", shkruan në përshkrimin e fotografisë Oriola.



Këngëtarja shqiptare tregon hapur sa e ka "pazarin"

Dihet botërisht se industria e muzikës nxjerr shumë të ardhura dhe gjithashtu mbrëmjet 'live' paguhen akoma më shumë. Por përgjithësisht këngëtarët preferojnë të heshtin kur flitet për pagesat dhe rrallë e tregojnë hapur shifrën në fjalë. Nderkohë që s'të ndodh çdo ditë të marrësh një përgjigje konkrete nga këngëtarët e tjerë, Flaka Krelani e tregoi pa problem. E pyetur në emisionin se sa paguhet për një mbrëmje muzikore Flaka u përgjigj: "Minimumi 300".



Seminari i Akademisë "Marubi" mbi pavarësinë e medias Kërcënimi i medias shqiptare nga shtrembërimi i realitetit Ligjëratat u mbajtën nga personalitete të njohura

Fenomeni "Fake news" është trajtuar nga Akademia "Marubi". Tema e këtij seminari kishte në qendër median 'online' dhe raportin e saj me lajmin real. Rreziku i shtrembërimit të fakteve, censura, autocensura, dezinformimi e të tjera problematika zgjuan nevojën urgjente të këtij forumi. Pikënisja e ligjërimeve ishte pavarësia e medias nga pronarët e tyre. Dublimi i lajmit dhe shtrembërimi i argumentit sipas modelit "copy paste" nga një botues tek tjetri shkakton atë që ne e quajmë lajmi i rremë, të cilit nuk i gjejmë dot burimin apo citimin në origjinal. Pasojat e kësaj gjendjeje janë humbja e besimit tek media dhe e shkëputjes së publikut nga informacioni. Valla Kaimaki, përfaqësuese e Bashkimit Evropian në tryezë i dha rëndësi veprimi të shoqërisë për ndreqjen dhe rregullimin e aspekteve sociale, në këtë problematikë që ka shtrembëruar informacionet që duam. Regjisori Kujtim Çashku e vuri theksin te pavarësia, mënyrat e shtrembërimit të interpretimit,



raportin që zë video dhe piktura midis individit dhe informacionit. Më tej në fjalën e tij, Aleksandër Çipa, kreu i Shoqatës së Gazetarëve Shqiptarë pohoi se një çështje majft e rëndësishme është ajo e vakumeve ligjore të krijuara në fushën e medias 'online'. Shqetësimi i Çipës paraqitet duke treguar se dhe ai vet është ndeshur me këtë fenomen të ri, por masivisht të përhapur në Shqipëri. Një tjetër detaj prekës është se nuk ka editor dhe verifikim të thelluar të lajmeve. Të tjerë të ftuar vunë theksin mbi rëndësinë që ka raportin profesional në komunikim,

etika në media dhe mënyra se si e respektojmë njëri-tjetrin si individë, si profesionistë në Shqipëri dhe si shoqëri. Në përmblyllje të seminarit, Çashku i dha një hapësirë të konsiderueshme, që zë njeriu në raportin social. Ai la të kuptohet se në fund është mendja njerëzore, e cila përlllogarit distancën mes trillit dhe asaj që duket ditën për ditë. Sfida është e brendshme, në një kohë kur nuk do të mjaftonte vetëm një seminar për të vënë pikën mbi T, edhe pse jemi të vetëdijshëm para urisë që kanë për lajmin qindra media 'online' aktive.

Elita Rudi, një nuse tradicionale, bën gati pajën

Elita Rudi dhe Gjiko janë një ndër çiftet më simpatikë të "show bizz"-it shqiptar. Më në fund të dy konfirmuan se janë në përgatitje të dasmës së tyre. Pak më parë, Elita ka zbuluar disa detaje nga përgatitjet e ceremonisë. Në videon e publikuar, ajo ka treguar dhuratën me të cilën do të presë të ftuarit. Çifti më i dashur për publikun pritet të bëjë një dasmë të madhe, ku të ftuar veç familjarëve, do jenë edhe këngëtarët më të famshëm të estradës. Ata do e kurorëzojnë dashurinë e tyre më datë 25 shtator.



Në kulmin e debatit për Teatrin, deputeti shikon video për 'shtatë palë qejfe'...

Pak momente më parë në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese është diskutuar dhe miratuar mes debateve të ashpër dekreti i Presidentit Ilir Meta për draftin për ndërtimin e Teatrit Kombëtar. Por mesa duket kur gjithë kolegët po diskutonin dhe mbronin pikëpamjet e tyre, deputeti tashmë i larguar nga PDIU, Dritan Bici ka gjetur kohën të shikojë një ndeshje futboll në celularin e tij. Sakaq, mazhoranca ka votuar në parim dekretin e presidentit duke e dërguar përsëri për miratim në Kuvend.



Rama fotografohet në avion, shmang çmimet e "kripura"

Kryeministri Edi Rama është fotografuar nga qytetarët duke fluturuar me avion nga Roma drejt Tiranës. Ajo që bie në sy është që shefi i qeverisë ka zgjedhur të fluturojë me një linjë të zakonshme "Economy class" duke shmangur çmimet e "kripura" të "Business class", shkruan Tema. Rama mori pjesë në sesionin e 68 të Komitetit të OBSH në Romë, ku udhëtimi ka zgjedhur ta bëjë si qytetar i zakonshëm. Herë pas here, opozita ka adresuar një sërë akuzash të forta lidhur me udhëtimet e tij ku hera e fundit ka qenë një udhëtim me një charter drejt Torinos për të ndjekur takimin Juve - Lacio, i cili ishte siguruar nga drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare.



BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Nuk jeni të vetmit! Edhe ministri i Brendshëm i mban lekët te kasa e telefonit

Nëse mendoni se vetëm ju mbani para në cover-in e telefonit atëherë gaboheni. Ministri i Brendshëm italian Matteo Salvini, gjatë një emisioni televiziv në Itali, ka treguar pa dashje se në kasën e telefonit kishte 20 euro. Mesa duket ministri nuk i preferon shumë portofolat. Fotoja e Salvinit qarkulloi në të gjitha rrjetet sociale, duke marrë komente të shumta.



Erdogani merr dhuratë luksoze 400 mln dollarë, përballet me kritika të mëdha

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan mori një avion luksoz prej 400 milionë dollarësh nga emiri i Katarit javën e shkuar, duke shkaktuar një valë kritikash nga kundërshtarët politikë. Në përgjigje, Erdogan tha të hënën se Boeing 747-8 ishte një "dhuratë" nga Emir Tamim Bin Hamad Bin al-Thani. Presidenti turk hodhi poshtë pretendimet se e kishte blerë avionin. Ai u tha gazetarëve se Ankaraja kishte qenë e interesuar për blerjen e avionit, por emiri kishte këmbëngulur për t'ia dhënë si dhuratë. Erdogan, gjithashtu, pohoi se avioni i përkiste popullit të Turqisë dhe jo atij personalisht, duke shtuar se ai do të përdorte avionin për udhëtimet e tij. Mediat raportojnë se avioni ka dhoma bordi, salla pritje, kabinë luksoze dhe një spital funksional. Aeroplani është projektuar për të transportuar 76 pasagjerë.



GJENDJA NE RAJON DISKUTIMET

Kreu i Kosovës: Marrëveshja me Serbinë, vetëm përmes korrigjimit të kufirit

Hashim Thaçi paralajmëron: Do ndryshojë Kushtetuta

Vetëvendosja, protestë kundër presidentit më 29 shtator

Ditën e djeshme, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi ka mbajtur një konferencë për media ku ka thënë se marrëveshja me Serbinë i siguron Kosovës njohjen nga Serbia. Kreu i shtetit ka thënë se nuk do të ketë ndarje të Kosovës, por se do të ketë kujdes më të afirmuar për serbët e Kosovës. Ky kujdes ndaj serbëve sipas tij, nënkupton respektim të plotë të standardeve të këtij komuniteti. Ai më tej, tha se me arritjen e marrëveshjes finale do të ndryshohet edhe dokumenti i Ahtiasarit. "Ne duhet ta kuptojmë se në rast të arritjes së marrëveshjes Kosovë-Serbi, me njohje reciproke, do të ndryshohet edhe Kushtetuta e Kosovës, do të plotësohet dhe ndryshohet edhe dokumenti i presidentit Ahtiasari dhe do të kemi një dokument të përputhshëm me realitetin e ri që do të krijohet", tha kreu i shtetit. Ndërkaq presidenti i Kosovës u shpreh edhe një herë i vendosur se marrëveshja me Serbinë do të kryhet përmes korrigjimit të kufirit, ndërsa garantoj se nuk do të ketë korrigjim të kufirit përgjatë vijave etnike, dhe as eksod të popullsisë. Shembull të korrigjimit të kufijve mes shteteve Thaçi përmendi atë të Sllovakisë dhe Çekisë, të cilat sot i konsideroi i konsideroi si shtete model. Në vijim presidenti Thaçi u shpreh se marrëveshja paqësore Kosovë-Serbi, i siguron vendit njohjen nga Serbia si edhe bashkimin me Medvegjen e Bujanovcin. Thaçi hodhi poshtë zërat se marrëveshja me Serbinë do të sjellë destabilitet në rajon, pasi u shpreh ai gjithçka do të kryhet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Poashtu Thaçi u pyet edhe për deklaratën e ministrit të Jashtëm serb, Ivica Daciç se njohja e Kosovës do të bëhet kur shëlgju të bëjë rrush. Në një konferencë për gazetarët Thaçi tha se nuk që të komentojë deklaratat elektorale. "Të gjithë institucionet e Kosovës janë unik për çeljen e negociatave dhe marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë. Që do të nënkuptonte njohje reciproke. S'do të lejojmë Republika Serpska. S'e besoj se ndokush nga mbarësisë e institucionet është kundër bashkëngjitjes së Preshevës dhe Bujanovcit. Sa i përket ministrit të Jashtëm serb, si komentojë deklaratat elektorale të tyre. Të gjithë duhet të shohim platformën tonë, por të arrijmë në marrëveshje. Mos të merremi me politika ditore. As Serbia s'do të ecë as edhe një hap pa arritur në marrëveshje me Kosovën. Dhe ne do të jemi në status-quo pa marrëveshje. Kushdo që përmend luftë, koha e luftërave u krye në 1999. Mjaft kemi vuajtur nga tmerrret, tragjeditë. Askush në Kosovë nuk do që të kthehem pas. Edhe Haradinaj dhe Veseli,



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

HASHIM THAÇI

"Ne duhet ta kuptojmë se në rast të arritjes së marrëveshjes Kosovë-Serbi, me njohje reciproke, do të ndryshohet edhe Kushtetuta e Kosovës, do të plotësohet dhe ndryshohet edhe dokumenti i presidentit Ahtiasari dhe do të kemi një dokument të përputhshëm me realitetin e ri që do të krijohet", -tha kreu i shtetit.

Kryeministrja serbe: Deklarata e Thaçit për marrjen e Preshevës, jo serioze

Kryeministrja serbe, Ana Brnabic e ka cilësuar jo serioze deklaratën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, se nuk do të ketë marrëveshje të paqes në Presheva, Bujanovci dhe Medvegja nuk i bashkohen Kosovës. "Kjo deklaratë është jo serioze dhe unë menjëherë do të jem këtu për qëllime politike të brendshme, për disa brenda në Kosovë. Për këtë është e pamundur të bëhet marrëveshje. Është e pamundur për mua se si ata tani shtrihen në territorin e Serbisë gjendore", ka thënë sot Brnabic, shkruan "Danas". Presidenti i Kosovës Hashim



Thaçi përsëri propozoi mundësinë e korrigjimit të kufijve në një tekst autorial, përcjell Telegrafi. "Për ta arritur këtë qëllim, unë kam propozuar opsionin e korrigjimit të kufirit me Serbinë. Kam argumentuar se marrëveshja eventuale e

korrigjimit paqësor të kufirit me Serbinë, Kosovës i siguron njohjen nga Serbia dhe bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjes me vendin tonë", ka shkruar Thaçi. Në anën tjetër, ministri i Jashtëm serb, Ivica Daciç ka thënë se Serbisë i sugjerohet se korrigjimi i kufijve nuk është në opsion, sepse është joreale dhe se Beogradi nuk guxon ta kërkojë këtë. Ai tha se Serbisë po i ofrohet formimi i Asociacionit në këmbim të njohjes së parësishme të Kosovës, gjë që, sipas tij, nuk do të ndodhë.

Haradinaj: SHBA është kundër zgjidhjes ku preken kufijtë

Është e domosdoshme që të arrihet një marrëveshje ligjore - obligative në mes të Kosovës dhe Serbisë, por, që ajo të bëhet pa prekur kufijtë. Kështu është shprehur kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në intervistë i ftuar në "Zona B". "Kam pasur rastin të dialogoj me zyrtarë nga Depar-

tamenti Amerikan i Shtetit. Ata nuk sugjerojnë zgjidhje me territore apo kufij, por që kanë thënë se ju kemi lënë hapësirë liderëve që të arrijnë një zgjidhje të implementueshme që nuk destabilizojnë dhe është e pranueshme prej të tjerëve", është shprehur Haradinaj në "Zona B". "Mendoj që është gabim që në emër

të entuziastit të gjetjes së zgjidhjes të eksperimentojmë me veten". "Ne duhet t'i kryejmë punët e shtëpisë. Për Serbinë është më lehtë ta njohë Kosovën nëse i kryen punët e veta. Nuk mendoj se po shkojmë drejt zgjidhjes, kur hapim temën e kufijve", ka thënë ndër të tjera Haradinaj.

janë mbështes të dialogut", -tha Thaçi. Nga ana tjetër, ka pasur një reagim edhe të opozitës, ku partia Lëvizja për Vetëven-

dosje ka thënë se do të protestojë më 29 shtator. Ky fakt është bërë i ditur nga lideri i VV-së në një konferencë për me-

dia. Ai bëri thirrje që qytetarët t'i bashkohen protestës paqësore në Prishtinë. Lideri i VV-së tha se situata politike



Dialogu Kosovë-Serbi, Hahn: Do i lëmë të bisedojnë

Referendumi në Maqedoni, Komisioneri European për Zgjerimin: Çdo votë ka rëndësi

Në prag të referendimit për emrin e Maqedonisë, në një intervistë për "Deutsche Welle", Komisioneri European për Zgjerimin Johannes Hahn ka thënë se qytetarët duhet të japin votën të lirë dhe pasi kanë marrë informacione të pavarura. Ndër të tjera Hahn flet edhe për lirinë e medias në rajon si edhe bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë. "Zgjidhja e këtij konflikti ishte një nga shumë negociatat e drejtuara nga OKB dhe në shumë prej tyre nuk ka zgjidhje konkrete. Nga këto konflikte shumëvjeçare, që quhen "konflikte të ngjira", nuk është zgjidhur asnjë. Në këtë kuadër ishte ngjarje e papritur që më në fund liderët arritën të binin dakord për diçka. Dhe kjo po shihet si rruga e duhur për gjithë rajonin, për t'u bashkuar herët a vonë, shpresoj herët, Bashkimin European. Kështu që është vendimtare, është diçka që duhet njohur, që duhet komentuar. Prandaj Bashkimi European, por edhe përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë janë këtu dhe kjo është normale, është normale që ata të jenë këtu dhe të tregojnë angazhimin e tyre", - ka thënë Hahn. Ndërkaq lidhur me çështjen e dialogut Kosovë-Serbi Komisioneri Hahn ka thënë se ndërkombëtarët i kanë bërë të qarta detyrimet ndaj vendeve, por duke ua kanë lënë liderëve të dy shteteve në dorë për të vendosur. "Siç e kam thënë disa herë javët e fundit, është shumë herët të thuhet diçka rreth kësaj çështjeje. Kërkesa ime ka qenë dhe është 'lëri ata të bisedojnë'. Ata janë të vetëdijshëm tani që kjo ide u bë publike dhe cilat janë detyrimet, jo vetëm nga qytetarët por edhe nga komuniteti ndërkombëtar", - ka thënë ndër të tjera Hahn.

në vend është e rëndë dhe sipas tij aventurat personale të presidentit Hashim Thaçi, duhet ndaluar. "Presidenti i vendit shënon mbështetjen më të vogël nga qytetarët e Kosovës. Ky president nuk ka legjitimitet në vend. Vetëvendosje thërret protestë paqësore në

Prishtinë më 29 shtator, ditë e shtunë, në ora 14:00. I kemi institucionet e shtetit të kapur. Anëtarët e të gjitha partive dhe OJQ-ve të bashkohen në protestë. Pazaret e Thaçit dhe Vuçitit nuk duhet t'i paguajmë ne", -tha lideri i LVV-së, Albin Kurti.

Opinion *i* Ditës


Reshat Arbana, 78-vjetori i gjigantit të skenës

Nga Josif Papagjoni

(vijon nga faqja 1)

... Dhe shumë respekt. Krejt shoqëria është krah tyre sikundër ata janë pasqyra e shoqërisë, më saktë e shpirtit dhe filligranës, e kapilarit më të imët ku ajo bulbon. Sepse arti nuk është vetëm një terapi, por dhe më e përsosura vlerë shpirtërore, ku jemi që të gjithë aty, gjejmë veten, kuptojmë humbjen dhe vuajtjen, lumturinë dhe këndelljen estetike, gjithçka. Por kur shteti si vetëdija absolute e një kombi hedh sytë me nderim nga figurat e mëdha të artit, bukur mirë për të, bukur mirë për artistin, bukur mirë dhe për të gjithë ne. E pra, unë e vlerësoj kujdesin e Bashkisë Tiranë dhe kryebashkiakut të saj Erion Veliaj, tok me ministren e Kulturës Mirela Kumbaro, që u bënë pjesë e tavolinës së kësaj feste për Reshatin. Unë u ndjeva vërtet i respektuar prej tij që isha i ftuar aty. Një artist si Reshat Arbana, i një përmase të përpërsëritshme besoj, që të imponohet me personalitetin e vet, me figurën gati të mitizuar nëpër role të shumta, tejet serioz dhe dinjitoz, një imazh lundruës mes nesh, ma rrëmbeu penën saora. Kam shkruar shpesh për rolet e tij dhe kam ndërjer emocion nga loja e furishme e një kahu dramatik që ai bën, shpesh e shoqëruar me shpërthime dhe vrulle ndjenjash të trazuar. Besoj se loja e tij në castet më fatlume mbërrin tek dimensionit i sublimës dhe të madhërsishmës. Më është dukur si një përrua i rrëmbyeshëm, si një katarakt që thyhet shkëmbinjve, zhurmon, të frikëson dhe ja tek copëtohet në mijëra stërkala blu duke krijuar një ylber ngjyrash: shpirtin njerëzor...

Ai lindoi në Tiranë, më 15 shtator. Kreu shkollën e lartë për aktor "Aleksandër Moisiu" në vitin 1965, duke qenë brezi i parë i aktorëve të shkolluar që i afroreshin emrave të Naim Frashërit e Kadri Roshit, Mihal Popit e Sulejman Pitarkës. Fillimisht punoi si regjisor në "Radio Tirana" nga 1965 deri më 1973, kurse nga 1974 deri më 1992 ka qenë aktor i parë në Teatrin Popullor. Nga viti 1992 e në vijim ai është aktivizuar në projekte të ndryshme teatrore apo filma si aktor i lirë në interpretimin e disa roleve. E para gjë që të vjen në gojë për Reshat Arbanën është se ai spikati si aktor i planit dramatik dhe psikologjik; karakterizohet nga një lojë që gërshton castet e qeta, rrëfimtare e të shtrira me ato shpërthyes, të ngjeshura dhe emocionale; ka një zë të plotë e kumbues, herë-herë në tone epikë. Me lojën e tij ka sjellë një galeri tipash, që ndryshojnë sipas kohës, vendit, shtresimeve sociale, ngarkesës së tyre psikologjike dhe temperamentit. Në vitin 1974 inter-



pretoi rolin e Selimit në dramën "Familja e peshkatarit" të Sulejman Pitarkës, ku paraqiti një njeri kokëfortë, të bindur e të pakthyeshëm në rrugën e bjerjes së tij politike e morale. Një vit më vonë i dha trajtë ekspresive personazhit të vështirë e kontradiktur prej fshatari të varfër, hallexhi, por lakmitar e kokëshkretë, Pilo Shpiragut në dramatin e romanit "Lumi i vdekur" i Jakov Xoxes, një shfaqje dhe rol embleme për kohën. Në teatër ka realizuar 24 role kryesore dhe të tjerë dytësorë. Prej tyre janë bërë më të njohura në kohë, gjithashtu, roli i presidentit të drama "Luiza Miller", e F. Shilerit, 1979, përmes të cilit paraqiti prindin zëmërgur dhe pushtetarin egoist e të vrazhdët; roli i Beqir Agës të drama "Lulet e shegës" e Kolë Jakovës*, 1977, i cili, ani pse i lë haraç skemës ideologjike të kohës, aktori krijoi fytyrën e njeriut dinak, të egër; përplot tinëzi, por ama të lidhur fort me pronën dhe pasurinë, andaj dhe i besueshëm në bëmat e tij. Personazhi kompleks i Uill Lomemit të drama "Vdekja e një komisioneri" e Artur Milerit, 1979, e sollti atë në një përmase gati eksperimentale, duke vënë në spikamë me zgjuarsit delirin dhe frikën e njeriut të vogël në shoqërinë postindustriale amerikane, i shkatërruar nga mbijetesja e vështirë, shterimi i tij psikik nën trysni, që i imponohet nga tregu informal, si dhe zhgënjimi që pëson nga iluzionet. Më së shpeshti, Arbana është dalluar si mishërues i personazheve që vijnë nga shtresat popullore, punëtorë, fshatarë ba-

bxhanë e ironikë (p.sh. xha Demit të drama Komunistët e R. Pulahës*, 1981) apo edhe nëpunës, protagonistë e antagonist. Ai rreket të zbulojë tek ata cilësi njerëzore të "fshihura", që shfaqen befasisht në çastin e konfliktit, duke depërtuar në pëshqjellimet e brendshme shpirtërore. Parapëlqen një tonim përgjithësisht të "ashprë" të zërit dhe të sjelljes, ashtu sikundër në çaste pendese, reflektimi a përvuajtjeje, ai bëhet i thyeshëm, i butë, me spikama e rrafshë psikologjike vibrante, sikurse është vënë re kjo në role të tilla si Delo Sinani të drama "Përballë vetes" e R. Pulahës.

“

Ndodh shpesh që një aktor identifikohet, ose e identifikojnë me një figurë. Masa e gjërë e telespektatorëve, edhe nga një ndjeshmëri e thukët kombëtare, e ka identifikuar Reshatin me Isa Boletin.

Pas një heshtjeje prej disa vitesh në skenën e Teatrit Kombëtar, në vitin 2004 ai erdhi sërish me rolin e profesorit në dramën "Streha e të harruarve" të R. Pulahës, ku rishfaqti ndjeshmërinë, fuqinë dhe gjerësinë e tij të njohur aktoriale. Rëndom gjatë lojës u mëshon kundërshtive dhe kolizionit që shpreh e përfaqëson personazhi në vepër. Priret kah ballafaqimi i hapur si dhe konfliktualiteti në veprimin apo në marrëdhënien me personazhet e tjerë. Në vitin 2018, në moshën 78-vjeçare, erdhi rishtazi në skenë me rolin e baba-it në dramën homonime të shkrimtarit francez Florian Zeller, në teatrit "Skampa" të Elbasanit. Te ky rol ai shkriu përvojën më të mirë aktoriale vetjake duke krijuar mjeshhtërisht figurën mbresëlënëse të një të moshuari që vuan nga sëmundja e alzajmerit, me humbjen e kujtesës, shastisjen, dëshpërimin e moshës, frikën nga braktisja, krenarinë, prepotencën si dhe ndjeshmëri të tjera, të cilat i gërshetoj me një sens vërtetësie shembullore. E kam parë disa herë këtë rol dhe singerisht mendoj se çdo aktor, i vetëm dhe përballë vetes së tij, do të mendohej fort nëse mund ta luante vallë si ai! E pra, është nga interpretimet ku ti mrekullohesh. Dhe do të uroja që vrapin Reshat Arbana, paqka se ky rol është një kulm karriere, mos ta ndalte këtu!...

Një ndihmesë të vyer artistike R. Arbana ka dhënë në kinematografi. Ka interpretuar mbi 35 role duke krijuar një profil të spikatur artistik. U dallua për

sensin e tij realist dhe forcën e interpretimit qysh me rolin e Islamit të filmi "Dueli i heshtur", 1967. Ishte një personazh i frikshëm, njeri i krimtë që nuk i dridhej dora, prandaj dhe i besueshëm. Ndodh shpesh që një aktor identifikohet, ose e identifikojnë me një figurë. Masa e gjërë e telespektatorëve, edhe nga një ndjeshmëri e thukët kombëtare, e ka identifikuar Reshatin me Isa Boletin. Ai i dha dimension historik e të madhërsishëm figurës së këtij heroi e themeluesi të shtetit shqiptar në filmin "Nëntori i dytë", 1982, me gjestin e figurshëm teksa puth flamurin, mallëngjimin, qëndrimin prej dinjitar, hirin fizik, sado që ky ishte një rol i dytë e në përmase të vogla. Në vitin 1983 luajti figurën e vrazhdët të Ahmetit të filmi "Dora e ngrrohtë". Ai rol nuk ikën kollaj nga kujtesa. I vërtet sa s'ka. Me rolin e Daljan beut të "Kush vdes në këmbë", u nderua me Medalionin e Festivalit të 6-të të Filmit. Në vitin 1985 interpretoi Adnan Kodrën të "Hije që mbeten pas", kurse në vitin 1986 u nderua me Medalionin e Festivalit të 7-të me rolin e kryetarit të këshillit të "Kur hapen dyert e jetës", nëpërmjet të cilit paraqiti procesin e vështirë të reflektimit dhe të pendesës së një pushtetari vendor, fillimisht kapadai, autoritar dhe i vrazhdët e më pas në rikthimin të vetvetja e humbur. Fitoi çmimin "Aleksandër Moisiu" me rolin e inxhinierit Emilin të filmi televiziv "Rikonstruksioni", 1988.

Por Reshat Arbana ka dhe një gjerdan tjetër. Ai është recitues i njohur i poezisë shqipe, sidomos i vargjeve nga veprat e Gjergj Fishtës (poema "Lahuta e malcise" etj.), Ali Asllanit etj. Vargjet sikur ndizen, flukset dramatike, patosi, sa dhe prekja e të vërtetave tronditëse, kundërshtive, falë një satire të pamëshirshme, therëse gjër në asht, dëshmojnë se sa thellë ka hyrë aktori në frymën e vargut. Nuk lë dot jashtë vëmendjes të ky shkrim edhe role të tjerë si: Semi, filmi "Fijet që priten", 1976; Kovi, filmi "Pylli i lirisë", 1976; prefekti, filmi "Gjeneral gramafoni", 1978; Beqir aga të filmi "Kur hidheshin themelet", 1978; bimbashi, filmi "Liri a vdekje", 1979; Mark Ukaçgjerra, filmi "Të pafuarit", 1985; Kola, filmi "Flutura në kabrinë time", 1988; Kuke Memini, filmi "Balada e Kurbinut", 1990. Janë shumë dhe për secilin mund të shkruash po kaq shumë. Për vlerat dhe meritat e tij ai mban titujt "Artist i Popullit" dhe "Nderi i Kombit". Por besoj se ai mban titullin më të madh të mundshëm, emrin e tij - Reshat Arbana - një nga lavditë dhe krenaritë e të gjithë neve!...

Ta gëzojsh 78-vjetorin artist!...

Opinioni *i* Ditës

Natyra tiranike e nacionalizmit

Nga Harley Austin*

(vijon nga faqja 1)

... atëherë do t'i japim fund statizmit, injorancës dhe tiranisë së nacionalizmit. Përgjatë gjithë historisë, nacionalizmi, i përcaktuar si besnikëri dhe përkushtim ndaj kombit, ka qenë mjet i zgjuar i qeverisë për të prodhuar pëlqyeshmëri nga popullata. Pavarësisht luftërave, taksave, imperializmit, spiunimit ose censurës, tirania e qeverisë mund të mbështetet gjithmonë tek nacionalizmi i verbër, për të larguar vëmendjen nga shkeljet e të drejtave individuale. Me "patriotizëm" unë nënkuptoj përkushtimin ndaj një vendi të caktuar dhe një mënyre të veçantë të jetesës, që besohet të jetë më e mira në botë, por që nuk dëshirohet t'u imponohet njerëzve të tjerë. Patriotizmi është i natyrës mbrojtëse, si në rrafshin ushtarak, ashtu edhe atë kulturor.

Ndërkohë, nacionalizmi është i pandashëm nga dëshira për pushtet. Sikurse thotë Xhorxh Oruell, "qëllimi i qëndrueshëm i çdo nacionalisti është të sigurojë më shumë pushtet dhe më shumë prestigj, jo për vete, por për kombin ose njësinë tjetër, në të cilën ai ka zgjedhur të zhysete individualitetin e tij".

Një gjë që shumë njerëz nuk arrijnë ta kuptojnë, është se ka një ndryshim të madh midis patriotizmit dhe nacionalizmit. Patriotizmi është dashuria ndaj një vendi, kryesisht kulturës, tokës dhe njerëzve të tij. Ndërkaj, nacionalizmi është dashuria, zakonisht në formën e fanatizmit ndaj kombit, që do të thotë që qeveria sundon falë tij. Ndërsa patriotët e trajtojnë vendin e tyre me respekt dhe zakonisht mendojnë për veten e tyre, në vend se të ndjekin verbërisht propagandën, nacionalistët adhurjnë qeverinë, zakonisht të llojit tiranik, që e rrenon në mënyrë aktive vendin e tyre. Dhe kjo për shkak se nacionalistët mendojnë se qeveria është vetë vendi, ose të paktën manifestimi i tij dhe se të gjithë ata që kundërshtojnë dekrete të saj, kundërshtojnë në fakt vendin.

Patriotët janë zakonisht të gatshëm të luftojnë kundër një qeverie tiranike, që kërcënon të drejtat e tyre. Për dallim, nacionalistët hipnotizohen lehtësisht nga të gjitha propagandat, politikantët dhe gënjeshtarët e qeverisë së tyre. Ata pastaj manipulohen lehtësisht duke hequr dorë nga të drejtat, privatësia, armët dhe paratë e tyre ndaj qeverisë, duke menduar verbërisht se po sillen si "qytetarë patriotë".

Nacionalistët vazhdojnë të adhurjnë qeverinë dhe simbolet e saj, përmes lavdërimeve të pafundme, adhurimit të flamurit dhe besimit se është një genie e gjithëfuqishme ajo që sjell liri dhe prosperitet (kur në fakt, ajo i shkatërron aktivisht të dyja këto).



Pastaj, me një dorë në zemër dhe sytë e tyre mbi flamurin, do të heqin me kënaqësi dorë nga fëmijët e tyre për luftëra të pakuptimta imperialiste, nga paratë e tyre për pagesat e tiranëve, armët e tyre për "sigurinë e kombit" dhe privatësinë e tyre për "luftën ndaj terrorizmit".

Nuk është çudi pse nacionalizmi i popullarizuar ka sjellë gjithnjë tirani: nga kombet feudale të Europës mesjetare, dhe deri tek Amerika moderne. Nacionalizmi, është në thelb një "çek i bardhë" për qeverinë, që ajo të marrë sa më shumë pushtet që dëshiron. Me shtrembërimin e madh të realitetit të njohur si nacionalizëm, mercenarët imperialistë të qeverisë bëhen "patriotë që luftojnë për lirinë tonë" dhe ushtria e saj të tepër dhe policia e militarizuar bëhen simbol i "krenarisë dhe forcës kombëtare".

Në dekadën e fundit, nacionalizmi ka gjetur një metodë të re të popullarizimit të vetes, në mesin e generatës aktuale. Në vend të propagandës masive të shekullit XX dhe të periudhës pas sulmeve të 11 shtatorit, nacionalizmi u përdor si një mjet për të luftuar gojja "globalizmin".

Kjo ka krijuar ndarjen e rreme nacionalizëm vs globalizëm, që është ironike për shkak të statistikave problematike të të dyjave. Dhe ashtu si me shumicën e kundërvënieve të rreme, kjo gjith-

ashtu rezultojnë në zgjerimin e statizmit në të dyja mënyrat.

Globalizmi është ndoshta një term i njohur për shumicën e njerëzve. E megjithatë, nacionalistët e kanë ripërcaktuar krejtësisht këtë term, për të mishëruar gjithçka që ata përbuzin. Globalizmi në përgjithësi, nënkupton zgjerimin e politikave të huaja dhe ekonomike në një shkallë globale, e cila zakonisht nënkupton vetëm tregtinë e ndërlihdur nëpërmjet marrëveshjeve dhe organizatave si Bashkimi Europian.

Ndonëse kanë vetë defekte të shumta, nacionalistët i shtojnë një kuptim krejtësisht të ri globalizmit, në mënyrë që të krijojnë armikun e tyre. Ndërsa nacionalistët janë në favor të kufijve të mbyllur, të proteksionizmit dhe konceptit të tyre të "mbrojtjes së kombit", globalistët e supozuar, të cilët janë zakonisht një formë e elitës së pasur, plus çfarëdolloj komploti nacionalistësh që vendosin të përshijnë, mbështesin kufijtë e hapur dhe shkatërrimin e kombeve.

Sidoqoftë, ky konflikt patetik nuk bën tjetër, përveçse zgjeron fuqinë e qeverisë. Derisa këta nacionalistë pretendojnë të luftojnë "elitën globaliste" dhe "shtetin e tyre të thellë", qeveria merr një leje të plotë për të zgjeruar fuqinë e saj, nëpërmjet rregulloreve kufizuese të kufijve, rritjes së shpenzimeve ushtarake dhe rritjes së ndë-

rhyrjes së huajt. Ç'është më e keqja, nacionalistët besojnë se janë individë që besojnë tek liria. Ata mendojnë në një farë mënyre se pikëpamjet e tyre jash-tëzakonisht kolektiviste mbi kombin dhe mungesa e rëndësisë të së drejtave individuale, është duke e mbrojtur individin, ndërsa globalistët po përpiqen të tiranojnë.

Por në përpjekje për të luftuar tiranistët, ata në mënyrë të pashmangshme e mbështesin tiraninë e tyre të vërtetë, duke tërhequr fitjet e tyre: qeverinë. Për të mos për-mendur faktin, se ideja për ta bërë Amerikën xhandarin e botës dhe për të mbështetur luftëra të panumërta të panevojshme, është më shumë globaliste se sa çdo kufi "hapur". Nëse nacionalizmi dhe globalizmi nuk janë në kundërvënien me tyre, atëherë kjo nënkupton ekzistencën e një tjetër mundësie. Zgjidhja është e thjeshtë: individualizmi. Në vend që t'i sakrifikojmë të drejtat individuale në emër të "kombit" ose "botës", zgjidhja e vërtetë nuk shkel të drejtat tona si individë.

Në duhet të ndalojmë përhapjen e propagandës statistikore të identiteteve kolektive dhe të fillojmë të jetojmë dhe mendojmë për veten tonë. Vetëm atëherë do t'i japim fund statizmit, injorancës dhe tiranisë së nacionalizmit.

* Marrë nga "bota.al"

HOROSKOPI

DASHI
Një reagim i shpejtë nga ju do të zgjidhë një problem, i cili ju shqetëson prej kohësh. Një projekt i rëndësishëm do të ndalet për shkak të pozicionit të zymtë financiar. Shëndeti i një personi të moshuar në familje mund të shkaktojë tension.

DEMI
Meditimi dhe joga duhet të praktikohen për përfundim shpirtëror, si dhe fizike. Mund të fitoni miqëri sot, por mos i shpenzoni kot. Miqtë dhe anëtarët e familjes ju inkurajojnë në çdo hap që hidhni.

BINJAKET
Për një jetë të kënaqshme përmirësoni gjendjen e brendshme, e cila ndikon edhe të shëndeti mendor. Një qëndrim i juaj mjaft i pakujdesshëm mund të shkaktojë shqetësim në familjen tuaj.

GAFORJA
Mendja është porta e jetës, sepse gjithçka nëse është e mirë apo e keqe vjen përmes saj. Suksesin do ta kenë në dorë nëse qëndroni të fokusuar në punën tuaj. Me shpenzimin e parave tregoni kujdes.

LUANI
Buzëqeshni pasi është antidoti më i mirë për të gjitha problemet tuaja. Sot ju duhet të përqendroheni në çështje që lidhen me pasurinë të paluajtshme ose projekte kulturore. Një udhëtim i shkurtër për të afërmin sjell momente relaksimi për ju.

VIRGJERESHA
Mbajni emocionet dhe impulset tuaja nën kontroll. Mendimet tuaja dhe idetë e vjetra pengojnë zhvillimin tuaj dhe krijojnë pengesa për të lëvizur më tej. Pozicioni i parave do të përmirësohet më vonë gjatë ditës.

PESHORJA
Disa momente të vështira financiare do të kapërcehen me ndihmën e prindërve tuaj. Disa prej jush mund të ndërmarin një udhëtim të largët që mund të shkaktojë tension.

AKREPI
Projektet e vetë-përmirësimit do të paguhen në më shumë se një mënyrë. Do të ndiheni më mirë dhe më të sigurt për veten tuaj. Kontrolloni tendencën tuaj për të jetuar jetën sikur të ishte dita e fundit sa i përket shpenzimeve.


SHIGJETARI
Sot humbjet financiare duken të mundshme nëse investoni duke u besuar fjalëve të të tjerëve. Problemet e një mikut mund t'ju bëjnë të ndiheni keq dhe të shqetësuar. Parashikohet një ditë e mbingarkuar.

BRICJAPI
Ka të ngjarë të kaloni kohën tuaj duke u marrë me sport për të ruajtur qëndrueshmërinë tuaj fizike. Mund ta gjeni veten në një situatë të re emocionuese, e cila, gjithashtu, do t'ju sjellë përfundim financiar.

UJORI
Duhet ta lësh pas të kaluarën nëse dëshironi të dilni nga pengesat sentimentale që ju mbërthejnë sot. Vendosni paratë tuaja në një vend të sigurt, gjë që do t'ju premtëjë përfundim dhe më shumë siguri në të ardhmen e afërt.

PESHQIT
Një ditë e mrekullueshme për të bërë gjëra që do të bënin të ndihesh mirë me veten. Mos shpenzoni shumë për t'u bërë përshtypje të tjerëve. Jeta romantike mund të jetë pak e vështirë.

Fjalëkryqi (1)



- 37. Janë baballarët.
- 38. Fillojnë titrat.
- 39. Ai dhe ajo.
- 40. Mbledh basketë separatistë.
- 41. Fillojnë saldimin.
- 42. Gjysma e krahut.
- 45. Në krye të armatës.
- 46. Gjysmë krisme.
- 47. Jepet për hartim.

- VERTIKAL**
- 1. Paul që qe poet i famshëm.
 - 2. Dennis i McLaren.
 - 3. Këndohet në opera.
 - 4. Gjysmë siklet.
 - 5. Kuftijtë e matjes.
 - 6. I zhvillon kongresi.
 - 7. Inicialet e Moravia-s.
 - 8. Janë krerë bandash.
 - 9. Të fundit në tender.

HORIZONTAL

- 1. Humanisti i Rotterdemit
- 6. Mund të jenë cigaresh.
- 12. Capirossi i MotoGP.
- 13. Eshhtë bixhoz
- 14. I vetmi në orar.
- 15. Para Diego në Kaliforni.
- 16. Fillojnë sefte.
- 17. Eshhtë makina për guidë.
- 21. Inicialet e Benigni-t.
- 23. Janë riparime.
- 25. Janë të brishtë.
- 27. Fillojnë largimin.
- 28. Ishin kambistë të dikurshëm.
- 29. Një motoskaft gare.
- 31. Kështu thirrej Marco Pantani.
- 32. Janë penjtë për moline.
- 33. Emër vajze.
- 35. Janë edhe ato të cirkut.
- 36. Nuk ka tradhtari.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Bëhet një me psonisje.
- 5. Një mund të jetë qeveritar
- 11. Maiden që këndojnë.
- 13. Një ushtarak është solemn.
- 15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
- 16. Teket pa kufij.
- 18. Mbetet në fund.
- 19. Një treshe në skenë.
- 21. Një mongol i Timurlengut
- 23. Një peshk i rëndë.
- 25. Triac ish-tenist
- 26. Kufizojnë një takim.
- 27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
- 30. Fillojnë nazet
- 31. Kalimi në krye.
- 32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
- 34. Janë portet.
- 35. Dashi kur mungon ai
- 37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
- 38. Kufizohet në kufij
- 39. Ente Civile Europeane.

VERTIKAL


- 40. Një birra.
 - 41. Mbetur në fund.
 - 42. Ramazzotti këngëtar
 - 43. Janë në modë.
 - 44. Janë tek në shaka.
 - 45. Eshhtë dite në mbledhje.
 - 47. Një pjesë e kandidaturave.
 - 49. Jessica Parker aktore.
 - 50. Inicialet e Presley.
 - 51. Akoma është ndryshe.
 - 52. Janë brijtë në skuadër.
 - 53. Qendër fitimi
- VERTIKAL**
- 1. Brad aktor.
 - 2. Komandohet nga gjenerali.
 - 3. Në hyrje të zonës
 - 4. Janë në skaje
 - 6. Janë librat e parë
 - 7. Mund të jetë arme.
 - 8. Inicialet e Turgeniev.
 - 9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
 - 10. Mund të lakohet.
 - 12. Janë araknidet si vejshua e zezë.
 - 14. Mund të jetë e lirë në port.
 - 17. Një mjet lundimi.
 - 20. Shkroi Rinoceronti.
 - 22. Ekstreme në ritëm.
 - 24. Kalohen në gjumë.
 - 28. Filmi i parë shqiptar.
 - 29. Fillojnë takimet
 - 31. Kufizojnë kënde.
 - 32. Një depozitë drithi.
 - 33. Janë vendet e para.
 - 34. Një parabolë e tenisist.
 - 36. Eshhtë logari që qërohet.
 - 37. Shteti me Khartum.
 - 38. Janë kapot e bandave.
 - 40. Një thirrje e dëshpërur nga direku.
 - 41. Lidhin brijë.
 - 42. Një lidhëz.
 - 46. King Cole i muzikës.
 - 48. Fillojnë ndeshjen.
 - 49. Sapo fillojnë.
 - 50. Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	6	3	1	9				5
				2				7
			4		6	3	8	
		1						
3	5			2			7	
7		5	3	8				
					6		1	
	2	9				4		
					9			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	8	4	5	6	9	3	7	1
3	7	6	4	8	1	2	5	9
1	9	5	7	2	3	8	6	4
4	6	2	8	3	5	9	1	7
5	1	8	6	9	7	4	2	3
7	3	9	1	4	2	5	8	6
6	4	1	9	5	8	7	3	2
9	5	3	2	7	6	1	4	8
8	2	7	3	1	4	6	9	5

Argëtim filozofik

- Nëse lumturia juaj varet nga ajo që bën dikush tjetër, keni një problem mjaft të madh.
- Një mori njerëzish e konsiderojnë veten të sëmurë edhe pse nuk janë, e një mori tjetër e konsiderojnë veten të shëndoshë edhe pse nuk janë.
- Kur dikush ju tregon hënën, mos shikoni gishtin.
- Të mos bësh asgjë, është më mirë se sa të jesh shumë i zënë duke bërë asgjë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	2		9	4	1	10		5	10	H	A	R	K	D	B	M	I	K					
2	F	7	8	6		15	3	6	10	3	A	B	I	B	I	M	O	R	E	A			
10	2		8	5	3		9	3	7	9	R	O	S	S	L	A	R	R	O	M			
5	K	1		2	3	11	3	4	7	5	8	4	A	N	A	D	E	R	I	M	I	A	
1	A		2	8	11	1	12	8	11	3	13	8	B	E	H	E	M	A	T	O	M	A	T
	5	3	6	3	12	8	13	8		1	6	E	H	A	B	A	N	E	R	A	A	A	A
5		11	3	16	3	6		6	6	1	L	E	R	E	R	A	E	A	N	E	T		
1		7	4	3	13	7	3		6		A	R	B	I	T	E	R	L	G				
2	3		8		7	5	1	11	3	4	T	A	R	A	B	I	T	E	R	L	G		
7	6		4	1	4	3	13	7	4	3	6	K	A	N	T	A	T	A	T	R	A		
11	3	2		16	8	11		9	15	4	A	I	A	G	A	B	A						
7	4	8	6	8		8	16		8	3	10	B	I	K	B	R	A	D	B	E			

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

O	R	A	K	U	L	L	I	P	R	A	G	U
P	A	T	R	I	O	T	K	I	L	M	E	R
E	L	I	A		F	O	R	A	R	I		
R	F	V	I	K	T	I	M	A	T	M	A	
A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	A	H	
M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	M	A	E
R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	M	A	E
E	T	O	E	O	T	T	K	A	T	E		
P	O	R	T	N	A	T	E	N	N	I	P	
A	R	I	A	E	L	E	O	R	I			
R	E	A	L	E	S	T	E	T	I	K	A	
T	T	L	E	S	T	E	T	I	K	A		

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

T	A	T	A	I	M	D	O	R	E	A		
U	R	A	T	P	A	P	A	O	D	E	T	
N	E	R	E	U	K	O	L	M	L	E	M	
E	N		D	A	L	I	L	A	I	O		
L	E	E	M	A	R	A	D	O	N	A	S	
I	V	P	R	O	V	O	K	A	T	O	R	E
N	I	O	L	I	N	E						
M	A	T	E	L	D	A		N	A	D	A	R
A	L	E	A	I	K	O	F	I	N	I		
K	T	M	R	A	B	L	I	D	I	K		
S	H	E	M	R	A	E	R	O	T	I	K	
I	N	T	R	I	G	A	A	L	I	U		

Thënie të mençura

- Njeriu që përqipet të arrijë idealin e vet, i ngjan udhëtarit, i cili në mbërmje hip në kodër, kur nuk është më afër yjeve, por i sheh më bukur ata.
- Nuk ka erë të favrosme për atë që nuk e di se ku shkon.
- Një padrejtësi nga e cila ne kemi fituar, quhet fat. Një padrejtësi nga e cila përfiton dikush tjetër, quhet skandal.
- Perënditë caktuan që, para suksesit, njeriu të djerstet.



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

maiora premunt/ gjëra të mëdha na presin

ZGJIDH UET NË RAUNDIN E DYTË

5 Diploma Profesionale / 26 Programe Bachelor / 1 Program i Integruar



DP - DIPLOMË PROFESIONALE / BA - BACHELOR / MP - MASTER PROFESIONAL / MSH - MASTER I SHKENCAVE / ME - MASTER EKZEKUTIV / PINT - PROGRAME TË INTEGRUARA / DR - DOKTORATURË

FAKULTETI
I EKONOMISË BIZNESIT
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI SHKENCAVE
JURIDIKE, POLITIKE
DHE MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI
I SHKENCAVE HUMANË
EDUKIMIT DHE
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI
I INZHINIERISË,
INFORMATIKËS
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI
I SHKENCAVE
MJEKËSORE TEKNIKE

Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë, Cel. 068 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al

